

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6099
E premte, 28 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Veseli: PDK-ja mbështet angazhimin e ShBA-së në dialog, por nuk do të jetë pjesë e delegacionit **FAQE 5**



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MË 30 GUSHT MBAHEN ZGJEDHJET PARLAMENTARE NË MAL TË ZI **FAQE 4-5**

KOSOVA DHE SHQIPËRIA FTOJNË SHQIPTARËT E MALIT TË ZI PËR VOTË HISTORIKE

Udhëheqësit e Republikës së Kosovës dhe ata të Shqipërisë u kanë bërë thirrje shqiptarëve të Malit të Zi që të dalin në numër sa më të madh në zgjedhjet parlamentare. Ata kanë bërë me dije se dalja sa më e madhe në numër e qytetarëve në këto zgjedhje avancojnë përfaqësimin politik të shqiptarëve. Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri shqiptar Edi Rama i kanë ftuar ata ta votojnë Listën Shqiptare, kurse presidenti shqiptar Ilir Meta dhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli, nuk kanë përmendur subjekte të caktuara. Subjektet politike shqiptare që janë ndarë në dy koalicione në këto zgjedhje synojnë t'i marrin disa mandate në Parlamentin e Malit të Zi



SBASHK-u KËRKON QË TË SHTYHET VITI I RI SHKOLLOR PËR DISA DITË



Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës e Kosovës (SBASHK) ka kërkuar nga Qeveria e Kosovës dhe Ministria e Arsimit dhe e Shkencës që viti i ri shkollor të shtyhet për dhjetë ditë. Sipas SBASHK-ut, pjesa më e madhe e shkollave ende nuk janë dezinfektuar, dhomat e mësimt nuk janë pajisur me dezinfektues për duar, nuk janë siguruar maskat mbrojtëse për personelin arsimor, nuk është përgatitur lista e mësimdhënësve rezervë për t'i zëvendësuar mësimdhënësit e sëmurë e as nuk është shpallur ndonjë thirrje a konkurs për mësimdhënës vullnetarë **FAQE 6**

Gjashtë të vdekur, 141 raste të reja me Covid dhe 143 të shëruar **FAQE 3**



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

OPINION

RAPORTI I DICK MARTYT,
BANAL (38) **F. 11**

Shkruan:
Kudusi LAMA



STANDARDET E DYFISHTA
DHE TERRI INFORMATIV
I GJYKATËS SPECIALE! **F. 8**

Nga KMDLNj

AKTUALE

SELIMI: NJË 'ARMATË'
EKSPERTËSH PËRGATITI
POZICIONIN E KOSOVËS KARSHI
SERBISË NË UASHINGTON **F. 5**

DUMOSHI: PUNËSIMI I TË
RINJVE, NJË NGA OBJEKTIVAT
KRYESORE TË MKRS-së **F. 6**

EKONOMI

NJË FOND PËR MBROJTJEN
E MJEDISIT! **F. 11**

Shkruan: Ferat
SHALA



AZEMI KRITIKON DEPUTETËT:
ATA PO VAZHDOJNË LUKSIN,
KOMPANITË PRIVATE
PO FALIMENTOJNË **F. 9**

ZGJATET AFATI PËR PARAQITJEN
E KËRKESAVE PËR
RISTRUKTURIM TË KREDIVE **F. 9**

SPORT

LLAPI, ME DYSHEN
JANUZI - HALITI,
MBYLL AFATIN KALIMTAR **F. 18**

Kryeministri i Francës: Epidemia po fiton terren

Paris, 27 gusht - Kryeministri i Francës, Jean Castex, ka thënë se koronavirusi është përhapur te popullata franceze katër herë më shumë se një muaj më parë. Castex ka treguar se 21 zona janë ta klasifikuara tashmë si "zona të kuqe", krahasuar me

19 që kanë qenë një ditë më parë. "Epidemia po fiton terren dhe tani është koha që të ndërhyjmë", ka pohuar Castex në një konferencë për media në Paris. Edhe pse përhapja e koronavirusit është kryesisht midis të rinjve, pranimet në spitale grad-

ualisht janë rritur në rreth 800 pacientë në një javë. Castex ka thënë se synim i autoriteteve është që të bëjnë gjithçka "për ta shmangur izolimin". Ai ka theksuar se Ministria e Shëndetësisë po i harton planet. Franca është një nga vendet më të prekura

në Evropë nga koronavirusi. Ajo ka regjistruar mbi 291 000 të infektuar dhe mbi 30 000 viktima. Në aspektin global, koronavirusi ka prekur mbi 24 milionë njerëz. Prej tyre, mbi 826 000 kanë humbur jetën dhe mbi 15.8 milionë janë shëruar.



Justifikimet e Serbisë për rastin e vëllezërve Bytyqi janë "gjepura"

WASHINGTON, 27 GUSHT - Familjarë të vëllezërve të vrarë Bytyqi kanë thënë se presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, dhe qeveria e tij do të shpikin gjithmonë justifikime për të mos vënë drejtësi për rastin e tyre. Komentet vijnë si reagim ndaj një letre të raportueses së posaçme të Kombeve të Bashkuara për ekzekutime jashtëgjyqësore dhe arbitrare, Agnes Callamard, e cila ka kritikuar ashpër mënyrën se si Serbia e ka trajtuar rastin e vëllezërve Bytyqi.

Agron, Mehmet dhe Yll Bytyqi, shtetas amerikanë, me prejardhje nga Kosova, janë arrestuar në vitin 1999 në Serbi për shkak të, siç kanë thënë zyrtarët serbë, kalimit të



paligjshëm të kufirit. Ata janë liruar nga burgu pasi janë dënuar dhe më pas janë vrarë. Trupat e tyre janë gjetur në një varr masiv, pranë Petrovo Sello në lindje të Serbisë, në vitin 2001. "Është e qartë se qeveria

juaj e ka për obligim, në bazë të ligjit ndërkombëtar humanitar dhe instrumenteve ligjore vendase, ta hetojë përgjegjësinë penale të komandantëve dhe eprorëve, përfshirë Goran Radosavleviqin dhe Vlastimir

Gjorgjeviqin", ka shkruar Callamard në një letër dërguar autoriteteve serbe në muajin mars. "Më në fund, doktor Callamard i ka ekspozuar justifikimet e tyre që janë gjepura", tha Ilir Bytyqi, vëllai i tre të vrarëve, në një reagim dërguar mediave të enjten. Serbia u është përgjigjur hetimeve fillestare të raportueses së posaçme të Kombeve të Bashkuara në korrik të vitit 2019, duke thënë se nuk ka mundur ta ndjekë penalisht rastin e vëllezërve Bytyqi dhe asnjë krim tjetër të kryer gjatë viteve 1990, nën përgjegjësinë e komandës, sepse Kodi Penal i Serbisë nuk ka përfshirë dispozitën për përgjegjësinë e tillë deri në vitin

2006. Dy policë të akuzuar për ndihmë në likuidimin e vëllezërve Bytyqi, Sreten Popoviq dhe Millosh Stojanoviq, janë shpallur të pafajshëm me vendim të Gjykatës së Lartë në Beograd për krime lufte. Gjykata ka thënë se nuk ka prova për përfshirjen e tyre në vrasjet e kryera në korrik të vitit 1999. Një rezolutë e miratuar nga Dhoma e Përfaqësuesve e Shteteve të Bashkuara, në tetor të vitit të kaluar, u referohet fakteve për përfshirje në vrasje edhe të ish-zëvendësministrit të Brendshëm të Serbisë, Vlastimir Gjorgjeviq, dhe të ish-komandantit të xhandarmërisë serbe, Goran Radosavleviq-Guri.

Pence, amerikanëve: Nuk do të jeni të sigurt në Amerikën e Joe Bidenit

WASHINGTON, 27 GUSHT - Nënpresidenti i Shteteve të Bashkuara, Mike Pence, ka thënë se nëse Joe Biden zgjedhet president në zgjedhjet e nëntorit, në qytetet amerikane do të përhapet dhuna. "E vërteta është se ju nuk do të jeni të sigurt në Amerikën e Joe Bidenit", ka thënë Pence gjatë fjalimit në Konventën e Partisë Republikane. Ai i ka përshkruar votimet e ardhshme si zgjedhje midis ligjit dhe rendit në njërin anë dhe paligjshmërisë në anën

tjetër. Komentet vijnë derisa në Uiskonsin të ShBA-së janë duke vazhduar protestat e dhunshme, tash e katër net, për shkak të të shtënave të policisë kundër një afrikano-amerikani. "Presidenti (Donald) Trump dhe unë do ta mbështesim gjithmonë të drejtën e amerikanëve për të protestuar në mënyrë paqësore, por trazirat dhe plaçkitjet nuk janë protesta paqësore", ka thënë Pence.

Fitorja Trump - Pence do të nënkuptonte "rend në rrugët e



këtij vendi për çdo amerikan të çdo race, besimi dhe ngjyre", ka

thënë ai. Pence ka shtuar se dhuna në Kenosha të

Usikonsinit, shtet që Trumpi mezi e ka fituar në zgjedhjet e vitit 2016, dhe qytete të tjera "duhet të ndalojë". Në disa qytete të ShBA-së këtë verë ka pasur protesta kundër racizmit, të cilat kanë nisur qysh në fund të majit, kur afrikano-amerikani George Floyd ka vdekur në duart e policisë. Në zgjedhjet e nëntorit në ShBA do të përballen presidenti aktual Donald Trump, i cili vjen nga Partia Republikane, dhe ish-nënpresidenti Joe Biden, i cili vjen nga Partia Demokratike.

Jep dorëheqje komisionari i BE-së për tregti

BRUKSEL, 27 GUSHT - Komisionari për Tregti i Bashkimit Evropian, Phil Hogan, ka dhënë dorëheqje të mërkurën vonë, pasi Qeveria e Irlandës, vendit prej nga vjen, e ka akuzuar për shkelje të udhëzimeve për mbrojtje nga koron-

avirusi. Hogani ka marrë pjesë në një darkë, në një fushë golfi, me më shumë se 80 njerëz, në qarkun Galluej të Irlandës, më 19 gusht. Ai, po ashtu, është kritikuar për mosrespektimin e rregullave të karantinës, pasi ka arritur nga Brukseli në Irlandë.

Hogani ka thënë se nuk ka shkelur ndonjë ligj, por ka theksuar se "do të duhej të ishte më rigoroz" në zbatimin e udhëzimeve për frenimin e koronavirusit. Në deklaratën e dorëheqjes, Hogani ka thënë se i vjen keq që udhëtimi i tij në

Irlandë "ka shkaktuar shqetësime të tilla". "Përsëris kërkimfaljen time të përzemërt për popullin irlandez, për gabimet që kam bërë gjatë vizitës sime", ka thënë ai. Ndërsa presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der



Leyen, ka thënë se ishte mirënjohëse për "punën e palodhshme të Hoganit si komisionar i Tregtisë".

Raporti 24-orësh i Institutit Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK)

Gjashtë të vdekur, 141 raste të reja me Covid dhe 143 të shëruar

Gjatë 24 orëve të fundit në Kosovë kanë vdekur gjashtë persona si pasojë e infeksionit me virusin "Korona". Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike ka bërë me dije se gjatë kësaj periudhe kohore janë paraqitur edhe 141 raste të reja me Covid dhe janë shëruar 143 persona. Sipas IKShPK-së, numri total i rasteve pozitive me koronavirus ka shkuar në 12 981, prej këtyre 9 085 persona janë shëruar, 498 kanë vdekur, ndërsa raste aktive janë edhe 3 398



385 pacientë me Covid po trajtohen në spitalet e Kosovës

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar të enjten se në institucionet publike shëndetësore në Kosovë aktualisht janë të shtrirë 491 pacientë, prej tyre 385 janë të infektuar me koronavirus dhe po

trajtohen në klinika dhe spitale. Në raportin ditë të ShSKUK-së është thënë se 14 pacientë janë në respiratorë, 25 janë duke u trajtuar me makinat e frymëmarrjes CPAP, ndërsa 324 të tjerë janë me oksigjenoterapi.

Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se kjo është një ndihmë shumë e çmuar në këtë kohë të pandemisë. "OBSh-ja gjithnjë na ka ndihmuar dhe është një krah mbështetës, pa të cilin do ta kishim shumë të vështirë. Aktualisht përmes OBSh-së dhe partnerëve të tjerë po përpiqemi të futemi në radhë që të sigurojmë vaksinën

kundër Covid-19 (në rast se aprovohet për përdorim). Po ashtu, OBSh-ja do të sjellë në Kosovë edhe aparate për teste RT-PCR, me të cilat Instituti

Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës/IKShPK do ta shtojë edhe ndërrimin e tretë të testimeve", ka thënë Zemaj.

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 27 GUSHT - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës ka bërë me dije se brenda 24 orëve të fundit në Kosovë janë regjistruar gjashtë vdekje dhe 141 raste të reja me Covid-19. Në njoftimin për media, IKShPK-ja ka treguar se gjatë kësaj periudhe kohore janë shëruar 143 pacientë nga koronavirusi. "Gjatë 24 orëve të fundit në laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR dhe në laboratorët privatë, janë testuar gjithsej 534 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 141 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 6 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv. Numri total i rasteve pozitive është 12 981 raste nga 49 277 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 498 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 143 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 9 085 raste, kurse

numri i rasteve aktive është 3 398", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar edhe numrin e rasteve të reja me Covid sipas komunave. "Rastet pozitive janë nga: komuna Prishtinë 23 raste, komuna Pejë 20 raste, komuna Gjakovë 19 raste, komuna Gjiilan 15 raste, komuna Ferizaj 10 raste, komuna Prizren 6 raste, komuna Rahovec 6 raste, komuna Fushë Kosovë 5 raste, komuna Podujevë 5 raste, komuna Kamenicë 4 raste, komuna Klinë 4 raste, komuna Drenas 3 raste, komuna Kaçanik 3 raste, komuna Viti 3 raste, komuna Vushtrri 3 raste, komuna Deçan 2 raste, komuna Istog 2 raste, komuna Obiliq 2 raste dhe me nga një rast komunat Dragash, Lipjan, Mitrovicë, Shtime, Skenderaj dhe Suharekë", ka njoftuar IKShPK-ja.

QKUK-ja merr donacion edhe 238 oksigjeno-koncentratorë

Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka pranuar edhe 238 oksigjeno-koncentratorë, donacion i



Japonia mbështet Kosovën në luftën kundër Covidit

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka pritur në takim Mitsunori Ogasawara, i ngarkuar me punë në Ambasadën e Japonisë, me të cilin ka biseduar rreth ndihmës që Japonia është duke i ofruar Kosovës për t'u përballur me luftën kundër Covid-19. "Së fundi, së bashku kemi punuar ngushtë që të sigurohet një ndihmë e nevojshme për sigurimin e medikamenteve dhe donacioneve, të cilat janë të domosdoshme për trajtimin e pacienteve të

prekur nga pandemia Covid-19. Ambasadori Ogasawara sqaroi se shteti mik i Japonisë aktualisht është i gatshëm të ofrojë ndihmë dhe mbështetje për sektorin e shëndetësisë në Kosovë dhe kështu do të vazhdohet edhe në të ardhmen. Shprehja mirënjohjen time të thellë dhe e falënderova Japoninë për ndihmën e vazhdueshme që po i ofron Kosovës, sidomos gjatë kësaj kohe të pandemisë", ka theksuar Zemaj.



Më 30 gusht mbahen zgjedhjet parlamentare në Mal të Zi

KOSOVA DHE SHQIPERIA FTOJNË SHQIPTARËT E MALIT TË ZI PËR VOTË HISTORIKE

Udhëheqësit e Republikës së Kosovës dhe të Shqipërisë u kanë bërë thirrje shqiptarëve të Malit të Zi që të dielën të dalin në numër sa më të madh në zgjedhjet parlamentare. Ata kanë bërë me dije se dalja sa më e madhe në numër e qytetarëve në këto zgjedhje avancojnë përfaqësimin politik të shqiptarëve. Presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri shqiptar Edi Rama i kanë ftuar ata ta votojnë Listën Shqiptare, kurse presidenti shqiptar Ilir Meta dhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli, nuk kanë përmendur subjekte specifike. Subjektet politike shqiptare që janë ndarë në dy koalicione në këto zgjedhje synojnë t'i marrin disa mandate në Parlamentin e Malit të Zi

përpara të Malit të Zi drejt së ardhmes euroatlantike si pjesë e NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Lista Shqiptare është zgjedhja e duhur për ta vazhduar punën në të mirë të shqiptarëve dhe në drejtim të anëtarësimit të Malit të Zi në Bashkimin Evropian. Çdo kontribut i dhënë për avancimin e agjendës evropiane të Malit të Zi e çon përpara bashkimin e të gjithë shqiptarëve në familjen e madhe evropiane”, ka shkruar Thaçi në profilin e vet në “Facebook”.

Edhe presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se zgjedhjet e 30 gushtit janë një mundësi e shkëlqyer për ta forcuar edhe më shumë perspektivën evropiane të vendit të tyre. “Me këtë rast, shpreh bindjen se bashkëkombësit tanë në Malin e Zi do ta shfrytëzojnë këtë mundësi historike përmes pjesëmarrjes së gjerë,

njëkohësisht përmes mbështetjes së tyre për alternativat shqiptare, në mënyrë që përfaqësimi i tyre në Parlamentin e Malit të Zi të rritet, si dhe në të gjitha institucionet e ardhshme qeverisëse. Të jemi krenarë për rolin dhe kontributin historik që faktori shqiptar në Malin e Zi ka luajtur deri sot”, ka shkruar Meta në profilin e vet në “Facebook”. Ndërsa kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se zgjedhja e shqiptarëve të Malit të Zi në zgjedhjet e së dielës është e qartë. Me anë të një videomesazhi në llogarinë e vet në “Facebook”, u ka bërë thirrje të gjithë shqiptarëve në Malin e Zi, që në zgjedhjet e 30 gushtit ta votojnë listën shqiptare si dhe ta forcojnë bashkëpunimin me presidentin Gjokanoviq dhe forcën e tij politike. “Unë besoj se zgjedhja juaj është e qartë dhe shpresoj që vota juaj të jetë e bashkuar në

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 27 GUSHT - Liderët institucionalë të Kosovës dhe të Shqipërisë i kanë ftuar shqiptarët e Malit të Zi që ta dalin në numër sa më të madh të votojnë në zgjedhjet parlamentare të 30 gushtit. Ata kanë bërë thirrje që shqiptarët e asaj pjese ta shfrytëzojnë këtë mundësi historike që përmes pjesëmarrjes së gjerë në këtë

proces zgjedhor dhe mbështetjes së alternativave shqiptare ta rrisin përfaqësimin e vet në Parlamentin e Malit të Zi. Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka vlerësuar se Lista Shqiptare është zgjedhja e duhur për ta vazhduar punën në të mirë të shqiptarëve dhe në drejtim të anëtarësimit të Malit të Zi në Bashkimin Evropian. Sipas tij, komuniteti shqiptar në Mal të Zi ka qenë gjithmonë faktor

stabiliteti dhe ka luajtur rol konstruktiv dhe kontributdhënës në rrugën e integritit euroatlantik të tij. “Prandaj, duke njohur punën e tyre të vyer në të mirë të interesave kombëtare, edhe sot u bëj thirrje të gjithë bashkëkombësve tanë në Mal të Zi, që të dalin masivisht në zgjedhje për ta mbështetur Listën Shqiptare, në mënyrë që ta avancojnë përfaqësimin e tyre politik dhe ta sigurojnë ecjen



te forca e votës si dhe te proceset demokratike, si rrugët e vetme për të 'realizuar të drejtat dhe interesat kombëtare. "Me afrimin e datës 30 gusht, ditës së zgjedhjeve parlamentare në Mal të Zi, dëshiroj t'i ftoj të gjithë bashkëkombësit tanë shqiptarë që të dalin në votim dhe t'i votojnë partitë shqiptare. Shqiptarët duhet të kenë besim te forca e votës si dhe te proceset demokratike, si rrugët e vetme e të duhura për t'i realizuar të drejtat dhe interesat kombëtare. Po ashtu, duke votuar listat shqiptare ata forcojnë peshën e tyre për të ndikuar në vendim-marrjen e këtij shteti, në mënyrë që të përmbushen kërkesat e tyre legjitime", ka shkruar ai. Sipas tij, shqiptarët e Malit të Zi janë faktorë konstruktivë. Këtë e kanë dëshmuar me përkrahjen e referendumit të pavarësisë, e hyrjes në NATO dhe në të gjitha proceset e reformave demokratizuese të këtij shteti mik. "Forcimi i zëri të shqiptarëve në institucionet shtetërore të Malit të Zi është në dobi edhe të vetë këtij shteti fqinj, sepse shqiptarët kudo ku jetojnë e mbajnë të palëkundur orientimin euroatlantik dhe mbështesin pa kursim forcimin e liberal demokracisë dhe bashkëjetesës në diversitet", ka vlerësuar ai.

të njëjtin drejtim që fuqizojnë përfaqësimin tuaj në jetën politike të Malit të Zi dhe shkon në harmoni me zgjedhjen e duhur për atë vend që duhet të vazhdojë përpara. Prandaj, ju bëj thirrje të mos e lini për asnjë arsye pa e ushtruar të drejtën e votës suaj dhe ta mbështesni sa më fuqimisht Listën Shqiptare", ka thënë Rama.

Ai ka thënë se ajo listë nuk është thjesht një mbledhje partish shqiptare. Sipas tij, ajo po lidh për herë të parë shqiptarët në ato treva për ta mbështetur njëri-tjetrin dhe drejtimin euroatlantik të Malit të Zi. "Roli juaj ka qenë e mbetet i pazëvendësueshëm për pavarësimin e Malit të Zi, për zhvillimin e demokracisë shumëpartake dhe zhvillimin demokratik e social të Malit të Zi. Sot ju kryeni detyra të rëndësishme në të gjitha nivelet institucionale të shtetit tuaj për ta mbështetur procesin e integritetit evropian. Dhe mos harroni çfarë përpjekjesh ka bërë e bën diaspora e shkëlqyer e shqiptarëve nga Mali i Zi, si një zëdhënëse e fuqishme e interesave kombëtare anekënd botës dhe si mbrojtëse e frymës euroatlantike në tërësi", ka thënë Rama.

Edhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka ftuar shqiptarët e Malit të Zi që të dalin në zgjedhjet parlamentare të 30 gushtit dhe t'i votojnë partitë shqiptare. Në profilin e vet në "Facebook" ai ka shkruar se shqiptarët duhet të kenë besim

Veseli: PDK-ja mbështet angazhimin e ShBA-së në dialog, nuk do të jetë pjesë e delegacionit



PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, i ka kthyer sot përgjigje kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, i cili ka kërkuar që PDK-ja të delegojë një përfaqësues të vet në procesin e dialogut që do të zhvillohet më 4 shtator në Uashington dhe më 7 shtator në Bruksel.

Veseli nëpërmjet përgjigjes zyrtare ka rikonfirmuar qëndrimin zyrtar dhe të njohur të PDK-së, se e mbështetë fuqishëm angazhimin e ShBA-së dhe të BE-së në procesin e dialogut si partnerë strategjikë ndërkombëtarë. "Po ju shkruaj në përgjigjen e letrës suaj rreth

pjesëmarrjes së Partisë Demokratike të Kosovës në takimin e 4 shtatorit në Uashington dhe të 7 shtatorit në Bruksel. Takimi i ftuar në Shtëpinë e Bardhë, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i shërben dinamizimit të procesit të dialogut. Përfshirja e ShBA-së në dialog është siguri dhe inkurajim për shtetin e Kosovës. Ky është një momentum i ri, i cili duhet të shfrytëzohet nga Republika e Kosovës. Mbetet qëndrimi im se aty ku është Amerika duhet të jetë edhe Kosova, sepse Shtetet e Bashkuara të Amerikës, së bashku me Bashkimin Evropian, janë partnerët më

strategjikë të Republikës së Kosovës", është thënë në letrën e Veselit drejtuar Hotit.

Veseli ka thënë se PDK-ja do ta ushtrojë rolin kushtetues në procesin e dialogut si opozitë në Kuvendin e Kosovës, por nuk do të jetë pjesë e delegacionit. "Partia Demokratike e Kosovës mbështet vetëm një marrëveshje gjithëpërfshirëse dhe përfundimtare që është në përputhje me platformën tashmë të njohur të saj, e cila garanton njohjen e ndërsjellë, sovranitetin shtetëror, integritetin territorial, karakterin unitar të shtetit dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB", është thënë në letrën e Veselit.

Selimi: Një 'armatë' ekspertësh përgatiti pozicionin e Kosovës karshi Serbisë në Uashington



PRISHTINË, 27 GUSHT (ER) - Ministri i Drejtësisë nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Selim Selimi, ka folur të enjten për takimin e 4 shtatorit, i cili do të mbahet në mes të Kosovës dhe Serbisë në Uashington. Në një konferencë për media mbajtur të enjten, Selimi ka konfirmuar se ai do të jetë pjesë e takimit, pasi është i propozuari i partisë së tij për

delegacionin që do të udhëtojë për në Shtëpinë e Bardhë. Selimi ka bërë me dije se përbërja e këtij delegacioni pritet të bëhet publike nesër nga kryeministri Avdullah Hoti. "Listën e delegacionit e cakton kryeministri Hoti. Presim që sot ose nesër të bëhet e ditur. Prej AAK-së, unë jam i propozuar që të jem pjesë", është shprehur Selimi. Sipas tij, është një

numër i madh i ekspertëve që ka përgatitur pozicionet e Kosovës karshi Serbisë. "Delegacioni është i përgatitur, pasi ekziston një armatë ekspertësh që kanë kontribuar në përgatitjen e pozicioneve tona karshi Serbisë", ka thënë Selimi, duke shtruar se pozicioni i Kosovës është i qartë, se në dialog shkohet vetëm për njohje reciproke.

Standardet e dyfishta dhe terri informativ i Gjykatës Speciale!

Nga: KMDLNJ

Bashkësia ndërkombëtare në Kosovë, së paku deklarativisht kërkon transparencë dhe llogaridhënie, sidomos të sistemit të drejtësisë që jo në pak raste i nënshtrohet linçimit publik, personal dhe familjar nëse vlerësohet se janë jotransparentë apo nuk i nënshtrohen llogaridhënies. Madje disa OJQ që kanë mungesë të kompetencës profesionale, materialisht mbijetojnë duke u shndërruar në snajperistë kundër mosrespektuesve të transparencës dhe llogaridhënies. Transparenca dhe llogaridhënia janë kushte të domosdoshme për zhvillim të demokracisë, qëndrueshmërinë e saj dhe funksionim të shtetit të së drejtës.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar nuk janë asgjë tjetër përveçse një eufemizëm për Gjykatë Speciale. Se kjo Gjykatë Speciale është aktualisht pjesë e sistemit të Drejtësisë të Kosovës është e vërtetë aq sa të thuhet se është

pjesë e sistemit të Drejtësisë së Etiopisë. E Kosovës është llogaritur vetëm deri në momentin kur është votuar në Kuvendin e Kosovës. Pastaj, me aneks-marrëveshje është stërkequr dhe nuk ka ruajtur asnjë lidhje me sistemin e drejtësisë së Kosovës, përveçse kërkon nënshttrim absolut përmes përkrahjes së çdo kërkesë, pavarësisht nëse është në kundërshtim me sistemin e drejtësisë në Kosovë apo vullnetin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës. Ashtu siç e kanë votuar Ligjin për Gjykatën Speciale, deputetët e Kuvendit mund ta amandamentojnë këtë ligj apo edhe ta shpërbëjnë këtë gjykatë. Mirëpo kjo nuk lejohet dhe nuk mund të ndodhë për faktin se ndërkombëtarët, përmes frikësimit, kërcënimit dhe shantazhit e dhunojnë vullnetin e deputetëve sikur që përmes aneks marrëveshjeve në mënyrë automatike ia vazhdojnë mandatin vetes deri në çastin kur e informojnë BE-në e jo "themeluesin", Kosovën se e kanë përmbyllur aktivitetin. Gjykata Speciale vepron në kundërshtim të plotë



me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut e Kombeve të Bashkuara për faktin se ndan drejtësi selektive dhe nuk përmbush kërkesat për drejtësi për të gjitha viktimat sikur që nuk siguron përgjegjësi për të gjithë ata që mund të kenë kryer krime.

Deklarata e fundit nga Gjykata Speciale, se edhe nëse janë konfirmuar aktakuzat për qytetarët e Kosovës, kjo gjykatë nuk e ka detyrim të bëjë publike e që në mënyrë flagrante dhunon plotësisht parimin e transparencës dhe

llogaridhënies aq më parë që muaj më parë po kjo gjykatë bëri publik propozimaktakuzën kundër presidentit Thaçi dhe ish-kryetarit të Kuvendit Kadri Veseli e që nuk ka asnjë arsyeshmëri juridike përveç qëllimit për denigrim të personalitetit përmes linçimit publik duke keqpërdorur një propozimaktakuzë të pakonfirmuar. A është normale të ruhet konfidencialiteti i një aktakuzë të konfirmuar, kurse të bëhet publike një propozimaktakuzë e

pakonfirmuar përveçse nuk ka qenë qëllimi politik dhe ndikimi në procese politike?! Gjykata Speciale me këtë vendim në mënyrë flagrante, duke përdorur standarde të dyfishta, i ka shkelur të drejtat e njeriut të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit aq më parë që nuk ka pasur fare konfirmim nga gjykatësi i gjykatës paraprake. Të vetmen të "drejtë" që kjo gjykatë ia njeht Kosovës është se institucionet e Kosovës detyrohen t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet për të akuzuarit, familjet e tyre, avokatët sikur edhe t'i kompensojnë, në rast të pafajësisë, e që është krejtësisht e padrejtë, për faktin se qytetarët e Kosovës arrestohen, paraburgosen dhe vuajnë dënimin larg familjeve dhe në kundërshtim të plotë me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale të Kosovës dhe Rregullave Europiane të Burgjeve. Kjo gjykatë i trajton, sikur edhe shteti i Holandës, në mënyrë të padinjitetshme, avokatët mbrojtës, duke ua vështirësuar pajisjen me viza afatgjatë dhe në këtë mënyrë ndikon në përgatitjen e mbrojtjes cilësore dhe efektive.

Dumoshi: Punësimi i të rinjve, një nga objektivat kryesore të MKRS-së

Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, ka marrë pjesë të enjten në hapjen e trajnimeve që do t'i aftësojnë të rinjtë. Ajo ka thënë se punësimi i sa më shumë të rinjve dhe ndërlidhja e edukimit formal dhe joformal me tregun e punës është një nga objektivat kryesore që ka qeveria aktualisht, sidomos Ministria e Kulturës



EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 GUSHT - Ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, e shoqëruar nga zëvendësministri Halil Matoshi dhe Qazim Rrahmani, mori pjesë në hapjen zyrtare të trajnimeve që do të mbahen në kuadër të projektit "Përgatitja e të rinjve për përpunimin e të dhënave përmes SPSS-së dhe platformave të ngjashme për hulumtime", i cili do të realizohet në Komunën e Lipjanit dhe Komunën e Fushë-Kosovës nga Akademia INFINIT, me mbështetje të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Objektivi kryesor i këtyre trajnimeve është ofrimi dhe promovimi i mundësive për kyçe në tregun e punës, përmes trajnimeve për personat e papunësuar, me qëllim të pajisjes me njohuri,

shkathtësi punësimi dhe punësim. Ministrja Dumoshi u shpreh shumë e lumtur që ka rastin të shohë se si një angazhim i saj për avancimin dhe fuqizimin e shkathtësive të të rinjve ka arritur të realizohet. Dumoshi ka përsëritur edhe një herë gatishmërinë e saj dhe të MKRS-së për të qenë derë e hapur e të rinjve ambiciozë të cilët me vullnet dhe angazhim do të jenë pjesë e tregut të punës. "Punësimi i sa më shumë të rinjve dhe ndërlidhja e edukimit formal dhe joformal me tregun e punës është një nga objektivat kryesore që ka aktualisht qeveria, sidomos Ministria e Kulturës. Si ministri jemi përpjekur maksimalisht - brenda kapaciteteve tona - të ndihmojmë përmes thirrjes publike organizata rinore të cilat synojnë të integrojnë sa më shumë të rinjtë në tregun e punës si dhe organizata të cilat kanë sjellë përmes projekt-

propozimeve ide të reja, kreative e të realizueshme", ka thënë ajo.

Këto trajnime synojnë përgatitjen e të rinjve përmes sesioneve të edukimit joformal me rastin e aplikimit për vend të caktuar pune te punëdhënësit e ndryshëm, biznes ose shoqëri civile si dhe synojnë të ndihmojnë të rinjtë

në mëdyshje për zgjidhjet që duhet të bëjnë për profesionet e ardhshme. Kjo do të arrihet përmes mësimi të teknikave që i bëjnë ata më të suksesshëm dhe më të përgatitur për tregun e punës. Programi do t'i aftësojë të rinjtë për krijimin e bazës së të dhënave, njohjen me procesin e hulumtimit, njohjen me

variablat dhe nivelin e matjeve, krijimin e të dhënave të munguar, analizën deskriptive të të dhënave, eksplorimin e të dhënave me grafe, analiza korrelacionale dhe regresionale, teste joparametrike etj. Të gjithë të trajnuarve do t'u mundësohet ndjekja e trajnimit dhe qasja në materiale falas.

SBASHK-u kërkon që të shtyhet viti i ri shkollor për disa ditë

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBASHK) ka kërkuar nga Qeveria dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës që viti i ri shkollor të shtyhet për dhjetë ditë. Sipas SBASHK-ut, pjesa më e madhe e shkollave ende nuk janë dezinfektuar, dhomat e mësimi nuk janë pajisur me dezinfektues për duar, nuk janë siguruar maskat mbrojtëse për personelin arsimor, nuk është përgatitur lista e mësimdhënësve rezervë për t'i zëvendësuar mësimdhënësit e sëmurë e as nuk është shpallur ndonjë thirrje a konkurs për mësimdhënës vullnetarë



fektuar, dhomat e mësimi nuk janë pajisur me dezinfektues për duar, nuk janë siguruar maskat mbrojtëse për personelin arsimor, nuk është përgatitur lista e mësimdhënësve rezervë për t'i zëvendësuar mësimdhënësit e sëmurë e as nuk është shpallur ndonjë thirrje a konkurs për mësimdhënës vullnetar, nuk janë përgatitur dhomat e mësimi për ta siguruar distancën e duhur sociale, por nuk janë bërë edhe përgatitjet e tjera brenda ambienteve shkollore”, thuhet në këtë komunikatë.

SBASHK-u edhe në këtë takim ka përkrahur deklaratimet e MASH-tit

dhe të Qeverisë për sigurimin e një fondi për pagesën gjatë kohës së pandemisë për mësuesit e sëmurë rëndë.

Qeveria e Kosovës ka miratuar planin e Ministrisë së Arsimit dhe Teknologjisë për fillimin e vitit të ri shkollor parauniversitar në kohën e pandemisë së koronavirusit. Në bazë të këtij plani parashihet që mësimi të zhvillohet në tre skenarë: kthimi në shkollë, mësimi i kombinuar dhe mësimi në distancë.

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ramë Likaj, ka thënë se në kuadër të këtij master-plani janë konceptet për realizimin e mësimi për secilin nivel të sis-

temit arsimor, janë paraqitur skenarët dhe fazat se si do të fillojë viti i ri shkollor, po ashtu janë përshkruar edhe përgjegjësitë e secilit institucion të përfshirë. Sipas planit të Ministrisë së Arsimit, viti shkollor do të nisë në fazë.

E para pritet të nisë më 1 shtator dhe përfshin parashkollorët, klasat e para, të dyta, të treta, të gjashta dhe të dhjeta. Faza e dytë do të fillojë më 7 shtator dhe përfshin klasat e katërta dhe të pestë, ndërsa faza e tretë e mësimi do të fillojë më 10 shtator dhe do t'i përfshijë klasat e shtata, të teta, të nënta, të njëmbëdhjeta dhe të dymbëdhjeta.

**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 GUSHT - Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës së Kosovës (SBASHK) ka kërkuar nga Qeveria dhe Ministria e Arsimit dhe Shkencës që viti i ri shkollor të shtyhet për dhjetë ditë. “Duke shprehur vullnetin dhe dëshirën e sinqertë që viti i ri shkollor të nisë së mbari dhe që institucionet arsimore të jenë plotësisht të përgatitura për plotësimin e udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, në përpjekje për ruajtjen e shëndetit të nxënësve dhe personelit arsimor, SBASHK-u u drejtohet Qeverisë dhe MASH-tit me zërin e punëtorëve arsimorë, që nisja e vitit të ri shkollor të shtyhet për dhjetë ditë”, thuhet në komunikatën e SBASHK-ut. SBASHK-u ka bërë me dije se ka

mbajtur takim me kryesinë, kryetarët e nivelit komunal dhe universiteteve dhe me anëtarët e Këshillit Drejtues.

“Pjesëmarrësit e këtij takimi kanë deklaruar vlerësimet lidhur me gjendjen momentale në institucionet arsimore nga këndvështrimi i udhëheqësve sindikalë. Ata kanë deklaruar se personeli arsimor dhe tekniko-ndihmës shprehin vullnetin për ta nisur mësimin në objektet shkollore duke përkrahur në këtë mënyrë masterplanin e MASH-tit e të miratuar nga Qeveria, por numri më i madh i pjesëmarrësve kanë shprehur shqetësimin se shkollat ende nuk janë përgatitur për ta nisur vitin e ri shkollor sipas kushteve të parapara për masat mbrojtëse dhe plani i MASH-it. Duke argumentuar, ata kanë përmendur se pjesa më e madhe e shkollave ende nuk është dez-

Propozohen emrat për Komisionin e ri të Provimit të Jurisprudencës

**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË 27 GUSHT - Ministri i Drejtësisë, Selimi Selimi, ka mbajtur të enjten një konferencë për media përmes së cilës ka bërë me dije propozimvendimin të cilin Ministria e Drejtësisë ia ka bërë Qeverisë së Republikës së Kosovës për anëtarët e Komisionit për Provim të Jurisprudencës. “Sot së bashku me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë kam propozuar anëtarët e Komisionit për Provimin e Jurisprudencës. Propozimvendimi, i cili tani dërgohet në Qeveri e më pastaj në Kuvend, ka këtë përbërje: Aleksandër Lumezi - kryetar i komisionit, pyetës i lëndës E Drejta Penale, kurse për zëvendësanëtar i komisionit, Besim Kelmendi; Hasan Shala - anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E Drejta Civile (materiale dhe procedurale), kurse për zëvendësanëtar, Rafet Haxha, Nebojsa Boriqiq -

anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E Drejta Tregtare, kurse për zëvendësanëtar Mahir Tutuli; Afërdita Bytyqi - anëtare e komisionit, pyetëse e lëndës E Drejta Kushtetuese, Organizimi i Sistemit Gjyqësor të Kosovës, Bazat e Sistemit të Bashkimit Evropian dhe të Drejtat e Njeriut, kurse për zëvendësanëtar, Çerim Fazliji; Enver Peci - anëtar i komisionit, pyetës i lëndës E Drejta e Punës dhe e Drejta Administrative, kurse për zëvendësanëtar, Shqipe Qerimi”, ka thënë Selimi. Propozimi për anëtarë të komisionit bazohet në Ligjin Nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës, neni 4, paragrafi 2, ku përcaktohet se kryetarin, anëtarët e komisionit dhe zëvendësit e tyre i propozon ministri i Drejtësisë dhe i emëron Kuvendi i Kosovës, me mandat dy vjet, me mundësi riemërimi.

Ministri Selimi ka thënë se përbërja e Komisionit për Provimin



e Jurisprudencës reflekton aspektin gjinor dhe të komunitetit joshumicë. “Pas miratim-

it në mbledhjen e qeverisë, shpresoj që propozimi i tillë të marrë edhe mbështetjen e

deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës”, ka thënë ai.

Një fond për mbrojtjen e mjedisit!



Shkruan: Ferat SHALA

Që nga koha e krijimit të institucioneve të para të Republikës së Kosovës, në emër të mbrojtjes së mjedisit janë vendosur taksa, tarifa dhe gjoba të formave të ndryshme. Madje taksat dhe gjobat e tilla janë vendosur duke u bazuar në parimin “ndotësi paguan”, parimin “shfrytëzuesi paguan”, parimin e “rregullimit të dëmit mjedisor në burim” apo edhe në atë për “mbulimin e

shpenzimeve për dëmin mjedisor”. Nëse i hedhim një sy listës së taksave dhe gjobave që paguhen nga bizneset dhe qytetarët e Kosovës do të shohim se, mes të tjerash, kemi:

- Taksë ekologjike për automjetet e regjistruara në Kosovë;
- Taksa për shfrytëzimin e resurseve natyrore që paguhen nga kompanitë që shfrytëzojnë ujin, apo edhe kompanitë që shfrytëzojnë resurset minerare;
- Taksa dhe pagesa me rastin e licencimit dhe marrjes së lejeve mjedisore nga kompanitë që vlerësohet paraprakisht që kanë ndikime mjedisore;
- Taksa për importin e produkteve të ndryshme që mundë të kenë ndikime në mjedis sikurse janë ato për

import të qeseve plastike, për substancat ozonholluese dhe produkteve të ngjashme të dëmshme për mjedisin;

- Taksa për hyrje me automjete në zonat e veçanta natyrore sikurse është qendra e Brezovicës;
- Gjoba dhe kundërvajtje me rastin e tejkalimeve të kushteve të lejes apo edhe dëmit të shkaktuar në mjedis;
- Gjoba për hedhje apo djegie të mbeturinave;
- Gjoba dhe kundërvajtje për prerje ilegale të pyjeve;
- Detyrime për kthimin e mjedisit në gjendjen paraprake pas shfrytëzimit;
- ... dhe disa lloje të tjera të taksave dhe gjobave që mblidhen në emër të mbrojtjes së mjedisit.

Pra, bëhet fjalë për një buxhet vjetor që kap shifra dhjetëra milionëshe.

Gjithçka do të ishte në rregull sikur këto mjete që mblidhen në emër të mjedisit të grumbulloheshin në një fond të veçantë dhe t'i ktheheshin mjedisit në formën e granteve, projekteve apo subvencioneve. Por kjo aktualisht nuk po ndodh. Mjetet e tilla derdhen në buxhetin e shtetit të Kosovës pa ndonjë destinim specifik për mbrojtje të mjedisit.

Ka shumë arsye që na obligojnë ta bëjmë një fond të veçantë për mbrojtjen e mjedisit, e me këtë rast do t'i numëroj vetëm disa prej tyre:

- Mjedis i Kosovës ka nevojë që të këtë një fond të veçantë që do t'i mbështeste projektet për

përmirësimin e gjendjes mjedisore, apo edhe të ofronte subvencione për iniciativat mjedisore;

- Kosova ka bazë të mjaftueshme ligjore për ta bërë këtë fond dhe, po ashtu, detyrime ligjore për ta bërë këtë;
- Në Kosova tashmë ka disa forma të mbledhjes së taksave mjedisore të cilat mund të destinohen në një fond mjedisor;
- Ekzistojnë praktika e modeleve të zbatimit të këtij fondi jo vetëm në Evropë, por edhe në rajon që mund të merren si shembuj. Andaj është koha që kjo çështje të adresohet në mënyrën e duhur dhe që Kosova të ketë një fond për mbrojtjen e mjedisit.



Zgjatet afati për paraqitjen e kërkesave për ristrukturim të kredive

PRISHTINË, 27 GUSHT - Në mbledhjen e së enjtes Bordi Ekzekutiv i BQK-së mori vendim për zgjatjen e afatit deri më 30 shtator 2020 për paraqitjen e kërkesave për ristrukturim të kredive sipas

Udhëzuesit për Ristrukturimin e Kredive për shkak të Covid-19. Afati i deritanishëm ka qenë më 31 gusht 2020. “Udhëzuesi për Ristrukturimin e Kredive për shkak të Covid-19 u nxor nga Banka Qendrore e

Republikës së Kosovës më 8 qershor 2020 me qëllim të vendosjes së kriterëve mbi të cilat duhet të bazohet procesi i ristrukturimit të kredive në kushtet dhe rrethanat e krijuara nga pandemia Covid-

19, duke synuar që kredimarrësit në vështirësi financiare të kenë mundësi t'i përmblushin detyrimet e parapara me kontratë dhe ta zhvillojnë aktivitetin e tyre biznesor. Udhëzuesi në fjalë

aplikohet për të gjitha institucionet financiare të autorizuar për të ushtruar aktivitet të kredihënies në Republikën e Kosovës”, është bërë me dije në njoftimin e BQK-së.

Azemi kritikon deputetët: Ata po vazhdojnë luksin, kompanitë private po falimentojnë



Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve i Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf Azemi, ka kritikuar deputetët e Kuvendit të Kosovës se kanë shkuar në pushim pa e votuar Projektligjin e Rimëkëmbjes Ekonomike. Sipas tij, kompanitë private janë duke falimentuar si pasojë e situatës së krijuar nga pandemia

për stafin mjekësor pa përcjelljen e stafit të logjistikës, të QKMF-së dhe të spitaleve në nivel të Kosovës është bërë gabim dhe kërkojmë që të gjithë punëtorët teknikë që kanë të bëjnë me spitalet patjetër duhet të hyjnë në listën e pagave edhe për 300 euro, pra konform vendimit të qeverisë. Në të kundërtën, Këshilli i Përgjithshëm do të marrë vendim për protesta”, ka thënë ai, duke shtuar se është duke u keqpërdorur pakoja emergjente. Azemi ka treguar se si kompani të ndryshme private janë duke larguar punëtorë. “Kemi një kompani të mishit në Fushë-Kosovë, punëtorët e së cilës kanë kërkuar që pagat e tyre të kthehen, por ata, në vend se t’i marrin mjetet, kanë marrë

largimin nga vendet e punës”, ka treguar ai.

Në këtë drejtim Azemi ka thënë se punëtorët po largohen nga puna duke u zëvendësuar me punëtorë të rinj me qëllim të ikjes nga pagesa e kontributeve. Ai, po ashtu, ka treguar se policia e krimeve ekonomike është duke u marrë me keqpërdorimet që janë bërë karshi këtyre veprimeve.

Në këtë konferencë për media Azemi ka folur edhe për Projektligjin e Rimëkëmbjes Ekonomike, me ç’rast ka kritikuar deputetët e Kuvendit të Kosovës që kanë shkuar në pushim pa votuar këtë projektligj. “Nuk kuptoj si nuk u miratua Pakoja për Rimëkëmbjen Ekonomike. Këtë mosvotim në Kuvendin e

Kosovës nuk do ta kishin bërë as armiqtë më të mëdhenjtë të Kosovës. Ftoj gjithë punëtorët e sektorit privat që t’u kthehet ky borxh parlamentarëve kur ata ta kërkojnë votën tonë. T’i mbajmë në mend se ne kur patëm nevojë për ta, ata shkuan në pushime dhe po bëjnë luks, kurse punëtorët e sektorit privat dhe kompanitë janë drejt falimentimit. Shtetin e Kosovës nuk janë duke e falimentuar shtetet e tjera, por ajka që kemi votuar”, ka thënë Azemi.

Kurse për tërheqjen e 10-përqindëshit, Azemi ka theksuar se janë mbi 170 mijë punëtorë të sektorit privat të cilët mund t’i tërheqin 9 deri në 10 euro. Azemi në këtë konferencë për media ka kërkuar që të ngrehet paga minimale.

EPOKA
ERE
Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 GUSHT - Kryetari i Sindikatës së Punëtorëve i Sektorit Privat të Kosovës, Jusuf Azemi, ka thënë se kompanitë private po vazhdojnë t’i largojnë nga puna punëtorët. Këtë deklaratë ai e ka dhënë të enjten në një konferencë për media ku ka folur për gjendjen e punëtorëve të sektorit privat.

Azemi ka kërkuar nga qeveria që në listën e pagave për punëtorët shëndetësorë të hyjnë edhe punëtorët teknikë dhe ata të sigurimit të qendrave të mjekësisë familjare dhe të spitaleve ose, në të kundërtën, ka paralajmëruar që pas një jave do të protestojnë. Ai ka theksuar se qeveria me përjashtimin e këtyre punëtorëve nga lista e pagave ka bërë diskriminim. “Vendimi i qeverisë për pagesën

Shtyhet samiti i Forumit Ekonomik Botëror në Davos



PRISHTINË, 27 GUSHT - Samiti i Forumit Ekonomik Botëror, i paraparë të mbahet në Davos të Zvicrës në muajin janar, u shty për verën e vitit të ardhshëm për shkak të pandemisë së koronavirusit. “Këshilla e ekspertëve është se ne nuk mund ta mbajmë [samitin] në mënyrë të sigurt në janar”, tha përmes një deklaratë Forumi

Ekonomik Botëror.

Samiti, që mbledh udhëheqës të shteteve të botës, mbahet çdo vit në Davos, qysh më 1971. Forumi Ekonomik Botëror e portretizon veten si adresën kryesore për mbledhjen e elitës politike dhe biznesore, me qëllim të diskutimit të sfidave të globalizmit. Grupi tha se vendimi për ta shtyrë samitin

“nuk është marrë me lehtësi, pasi nevoja që liderët globalë të mbledhen dhe ta hartojnë shtetun e rimëkëmbjes” nga pandemia e koronavirusit, është “shumë urgjente”.

Forum Ekonomik Botëror tha se do t’i bëjë publike datat dhe lokacionin e takimit të shtyrë pasi të krijohen kushtet e shëndetit dhe të sigurisë.

“Pastrimi” nga 15 shtatori do t’i dërgojë borxhlinjtë te përmbaruesit privatë

PRISHTINË, 27 GUSHT - Qytetarët të cilëve u është mbledhur borxhi ndër vite ndaj Kompanisë Regionale “Pastrimi” do të përfundojnë te përmbaruesit privatë nga data 15 shtator. Këtë gjë kompania “Pastrimi” e arsyeton duke

thënë se është kompani publike me vetëfinancim, pra të hyrat e mjeteve financiare i siguron vetë dhe mospagesa e faturave të mbeturinave vështirëson punën e saj sidomos gjatë periudhës së pandemisë. “Inicimi i kësaj procedure

përmes përmbaruesve privatë do të krijonte shpenzime shtesë dhe do ta vështirësonte përbushjen e obligimit tuaj duke paguar taksën shtesë. Prandaj, publikisht u bëjmë thirrje qytetarëve që t’i kryejnë obligimet e tyre duke bërë

pagesat e faturave të mbeturinave. Për t’i ikur procedurës përmbarimore, qytetarët duhet të reflektojnë në kohë sa më të shpejtë për kryerjen e obligimeve të tyre të faturës së mbeturinave”, thuhet në njoftimin e kompanisë “Pastrimi”.



Latifi takon drejtorët e shkollave, diskutuan për fillimin e vitit të ri shkollor

RAHOVEC, 27 GUSHT (ER) - Në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Rahovecit, kryetari i komunës, Smajl Latifi, ka mbajtur takim me të gjithë drejtorët e shkollave të komunës. Gjatë këtij takimi është biseduar fillimi i vitit të ri shkollor 2020/2021 dhe zbatimi i masave për mbrojtjen nga pandemia Covid-19. U tha se nuk do të fillojë procesi mësimor pa u bërë dezinfektimi i objekteve shkollore. Po ashtu, për pesë shkollat që do të

mbahet testi i maturës dezinfektimi do të bëhet gjatë ditës së premte. Në hapje të takimit, Avni Morina, drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit, u shpreh se pjesë e këtij takimi janë edhe kryetari i Sindikatës së Arsimit për Komunën e Rahovecit, Veli Morina dhe koordinatoret e cilësisë për secilën shkollë. “Përgatitjet për mbajtjen e testit të maturës janë bërë me kohë dhe se para mbajtjes së testit, objektet e pesë shkollave ku do të mbahet

testi do të dezinfektohen. Kurse për fillimin e vitit të ri shkollor si DKA, në bashkëpunim me institucionet qendrore si dhe kryetarin e komunës dhe drejtorët e shkollave, i kemi marrë të gjitha masat e nevojshme që të mos ketë pengesa për fillimin e mësimi”, është shprehur drejtori Morina. Kryetari i komunës, Smajl Latifi, u ka thënë drejtorëve të shkollave se në asnjë shkollë nuk do të fillojë mësimi pa u bërë dezinfektimi i objektit të shkollës.



Klina, pjesë e projektit të ekonomisë së gjelbër

KLINË, 27 GUSHT (ER) - Komuna e Klinës është bërë pjesë e projektit “Kapërcim i gjelbër-drejt ekonomisë së gjelbër vendore përmes investimeve inteligjente”, i cili mbështetet financiarisht nga delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri dhe implementohet nga dy organizatat mjedisore aktive, “Balkan Green Foundation” dhe qendra “EDEN” si dhe Bashkia Has.

Ky projekt është duke vendosur një mentalitet të ri, i cili ka për synim një transformim sistematik, inteligjent, që hap rrugën drejt një rritjeje të qëndrueshme ekonomike dhe mbrojtje të mjedisit të dy komunave partnere. Duke marrë parasysh që ky projekt është në kuadër të Programit për Bashkëpunim Ndërkufitar (BNK) për mjedisin midis Shqipërisë

dhe Kosovës, është vlerësuar si mjaft i rëndësishëm për Komunën e Klinës, sepse do ta promovojë këtë komunë dhe Bashkinë Has në Shqipëri si nismëtare të ekonomisë së gjelbër, por do ta inkurajojë edhe bashkëpunimin ndërkufitar, duke krijuar kushte për zhvillim të qëndrueshëm ekonomikë jo vetëm të zonës, por edhe të dy shteteve si tërësi.

Fillon aksioni për dezinfektimin e fshatrave të Ferizajt

Ferizaj, 27 gusht (ER) - Aksioni i nisur ditë më parë për dezinfektimin kundër mushkonjave në qytetin e Ferizajt ka vazhduar edhe në fshatra. Përveç përfundimit të dezinfektimit në disa rrugë të qytetit, janë katër ekipe që po kryejnë dezinfektimin edhe në një pjesë të fshatrave për të vijuar sipas radhës në të gjitha fshatrat e Ferizajt. Ky aksion po monitorohet nga inspektorët

komunalë dhe vetë kryeinspektori i Ferizajt, Ridvan Berisha, i cili ka marrë pjesë në monitorimin në terren të këtij aksioni. Po ashtu, tash kur edhe pak ditë nis procesi mësimor, ka nisur edhe dezinfektimi i objekteve shkollore të cilat do të jenë të gatshme për nisjen e procesit mësimor sipas rregullave e udhëzimeve për mbrojtjen e shëndetit publik.



Haskuka emëron Nora Kelmendin drejtoreshë për Gjeodezi, Totaj e quan veprim të gabuar

Prizren, 27 gusht (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, ka emëruar Nora Kelmendin në pozitën e drejtoreshës për Gjeodezi dhe Kadastër (DGJK). Haskuka ka thënë se Kelmendi ka një përvojë mjaft të gjatë në këtë fushë. “Falënderoj drejtorin e deritanishëm, Bajrus Sezairi, për punën e realizuar për përmirësimin e shërbimeve në DGJK, kurse drejtoreshës Kelmendi dhe stafit të saj i uroj punë të mbarë në reformat e

brendshme për shërbime edhe më kualitative. Me këtë rast, më lejoni ta shpreh kënaqësinë që tanimë gjashtë drejtori të Komunës së Prizrenit janë nën udhëheqjen e grave të suksesshme, me të cilat do të vazhdojmë të punojmë drejt përmbushjes së zotimeve tona”, ka thënë ai. Ndaj emërimit të Kelmendit në këtë pozitë ka reaguar kryetari i Degës së PDK-së, Shaqir Totaj, i cili e ka quajtur të gabuar një veprim të tillë. “Kryetari

Haskuka, drejtoreshë për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren e paska emëruar znj. Nora Kelmendi, e cila, sipas tij, ka një përvojë mjaft të gjatë në këtë fushë. Hap tjetër në drejtim të gabuar ku tani, përveç kualitetit të jetës së qytetarëve, injorohen edhe profesionistët e shumtë apolitikë të Prizrenit, tregues ky relevant i mungesës serioze të performancës së kryetarit Haskuka. Qyteti i bukur i Prizrenit meriton shumë më tepër se kaq”, ka shkruar Totaj.





Flet akademik Muhamedin Kullashi (3)

Vdekjen e filozofisë e shpallën rrymat pozitiviste e scientiste



Intervistoi: Prof. dr.
Haqif MULLIQI

Muhamedin Kullashi është intelektual *par excellence*. Është kënaqësi e madhe që të bisedosh me të dhe të përballësh me elokuencën dhe poliedrizmin e tij. Është akademik. Disa vjet ka qenë profesor në Universitetin "Paris 8" në Francë. Është filozof i shquar, vlerësimet për të cilin janë bërë edhe jashtë hapësirave tona. Profesor Kullashi është autor i një numri të madh të veprave nga fusha e filozofisë e që, sipas mendimit tonë, janë libra që ngërthejnë në vete: filozofinë, sociologjinë, ontologjinë, antropologjinë, teorinë e artit dhe poetikën e tij. Krahas angazhimeve si profesor i njërit prej universiteteve më të njohur në botë, atij "Paris 8", profesor Kullashi kontribut të jashtëzakonshëm ka dhënë edhe për zhvillimin e filozofisë

në Universitetin e Prishtinës. Ajo që na ka mahnitur gjithmonë është se Muhamedin Kullashi është edhe njohës i pashoq i fushës së dramaturgjisë dhe teatrit. Titujt e librave të tij janë të shumtë dhe, prej rreth katër dekadash, si rrallëkujt, veprat e tij janë botuar edhe në gjuhën frënge. Profesor Kullashi disa vite ka shërbyer edhe ambasador i parë fuqiptotë i Republikës së Kosovës në Francë. Këtë intervistë me të e kemi realizuar për revistën për letërsi, kulturë, gjuhë dhe media, "Akademia".

Hajdegeri e ngriti një rëndësi prej hipotezave më të njohura mbi "vdekjen" e filozofisë, ndërsa këtë e bëri duke e diagnostifikuar shpërbërjen bashkëkohore të filozofisë nëpër shkencë të ndryshme shoqërore gjë që shpie te nihilizmi, paçka se, edhe pas vërejtjeve që i evidentoi Niçe, e me të cilat pajtohet Hajdegeri, ajo vazhdon me vetëprezantimin monolit, duke e kaluar kohën me nostalgji nëpër antikuarët tradicionaliste, duke i lustruar ato të vjetrat, në vend se t'i krijojë të reja. A mendoni se qëndron ky

përshkrim i Hajdegerit?

KULLASHI: Mendoj se ky "verdikt" i Heideggerit mund të merret me rezervë për disa arsye. Shpërbërja e filozofisë bashkëkohore brenda shkencave shoqërore dhe hovi që këto morën sidomos në shekullin XX mund të vlejë për ata filozofë që e kanë braktisur filozofinë dhe u janë dhënë tërësisht kërkimeve dhe shkrimeve nga degë të ndryshme të shkencave shoqërore (sociologji, histori, antropologji, etnologji etj.). Apo për ata filozofë që u janë përkushtuar dijeve të ndryshme pozitiviste e scientiste (Auguste Comte etj.) duke hequr dorë nga mëvetësia e të menduarit dhe kërkimet filozofike.

Do ta marr një shembull pak më kompleks: ka të bëjë me Habermasin, për shkrimet dhe teorinë e të cilit është thënë se shënojnë këtë shpërbërje të filozofisë brenda shkencave shoqërore. Kujtoj se në kërkimet e Habermasit kemi të bëjmë më shumë me një dialog, shpesh kritik por, megjithatë, dialog me ato shkencë shoqërore që i duken të frytshme së pari për sqarimin dhe ndriçimin e shumë problemeve të shoqërive

bashkëkohore, por edhe për një dialog të frytshëm me kërkimet filozofike. Megjithatë, Habermasi nuk ka hequr dorë nga filozofia dhe ka kultivuar veçantinë e të menduarit të saj në ballafaqime me çështje të ndryshme të botës bashkëkohore. Fjala vjen, në *Ligjërata filozofike e modernitetit* (1985) ai thekson se një nga efektet e dukshme të transformimeve në botën moderne shfaqet te pranimi, nga pjesa dërrmuese e shoqërisë moderne, i *lirisë* dhe i *barazisë* si vlera kyçe. Është fjala për një *risi të thellë* në krahasim me tërë historinë shumëshekullore të njerëzimit, në të gjitha qytetërimet, ku vendi i individëve dhe shtresave shoqërore ishte i përcaktuar, njëherë e përgjithmonë, brenda një hierarkie të ngurtë piramidale të shoqërisë. Më tutje, ndryshe nga Weberi, por edhe nga disa kritikë bashkëkohorë të modernitetit (Adorno e Horkheimer, Bataille etj.), Habermasi mendon se *arsyeja*, por jo si ndonjë realitet substancial, krahas shtrirjes së ndikimit të racionalitetit instrumental pragmatik, zhvillohet pikërisht brenda proceseve të debateve për nor-

mat e reja sociale dhe vlerat në saje të kriterëve autonome (e jo të imponuara nga hyjnia apo nga autoritetet tradicionale), shfaqet si forcë që *zgjeron gradualisht kufijtë e lirisë*. Këtu qëndron, për Habermasin, "potenciali emancipues i modernitetit", i lidhur me rritjen e racionalitetit në sfera të ndryshme të shoqërisë. Ky potencial është zgjuar e sajuar pikërisht në saje të prirjes së *modernitetit që t'i problematizojë të gjitha normat e vlerat tradicionale të individit e të shoqërisë* e, njëherësh, të formoj raporte, institucione dhe norma të reja që nuk mbështeten në ndonjë themel transcendent e as natyror, por dalin nga ajo që ai quan "veprimi komunikues". Mirëpo, duke zhvilluar tezën e vet për potencialin emancipues të modernitetit, Habermasi nuk lë anash kritikën e fenomeneve të ndryshme që cilësojnë shoqërinë moderne demokratike. Kësisoj, një aspekt i kësaj kritike është teza e tij mbi "kolonizimin e botës së përjetuar nga sistemi". Frymëzimin fillestar për konceptin e "botës së përjetuar", Habermasi e merr nga Huserli, i cili me këtë term nënkuptonte një qëndrim të

natyrshëm dhe *parateorik* që kanë individët ndaj botës. Bota e përjetuar ka të bëjë me një mori sigurish (pikëmbështetjesh) ose referencash pararefleksive që kanë të bëjnë sa me botën njohëse – instrumentale, aq edhe me atë normative e estetike – ekspresive.

Mendimi filozofik mund të bëhet i vdekur nëse reduktohet në një qëmtim arkivor. Megjithatë, të mos harrojmë se vetë Heideggeri theksonte se filozofia bashkëkohore për t'u ripërtërirë ka nevojë për një dialog me filozofinë poetike të parasokratikëve, fjala vjen me poemën e Parmenidit mbi natyrën. Vetë Heideggeri, por edhe filozofët e tjerë të mëdhenj, i kanë zbuluar dhe zhvilluar konceptet e tyre të reja të filozofisë në kohën e tyre, duke rimenduar njëherësh filozofinë antike greke, atë të Rilindjes, të Modernitetit, duke filluar me Descartesin, me iluminizmin francez dhe filozofinë klasike gjermane, si dhe së paku disa konceptione të periudhës bashkëkohore: origjinaliteti dhe krijimtaria filozofike e një filozofi të rëndësishëm supozon këtë dialog kritik e të frytshëm si dhe me ballafaqimin e problemeve kyçe të epokës në të cilën jeton.

Ç'është e vërteta, Heideggeri e bën dallimin midis një "qëndrimi muzeal" ndaj së kaluarës, që nënkupton një ruajtje pasive të të dhënave dhe ngjarjeve nga e kaluara, ndërkaq qëndrimi tjetër ndaj së kaluarës (*Erbe*, trashëgimi) e bën të mundur një përvetësim kritik e të frytshëm të diçkaje (një teori filozofike, bie fjala) nga e kaluara dhe ai hap *mundësi* të reja kah e ardhmja.

Sa iu takon *koncepteve* të reja mendoj se çdo filozofi e madhe ka prodhuar koncepte të reja mbi çështje të ndryshme, edhe pse kanë mundur të artikulohej me terma të ngjashme: në filozofinë bashkëkohore, fjala vjen, konceptet mbi "totalitarizmin", si edhe ato mbi "demokracinë" janë të ndryshme te Hannah Arendt, te Raymond Aron dhe Claude Lefort, ndonëse termi është i njëjtë. Në librin tim *Dy gjenealogji të modernitetit* (2016) i kam marrë në shqyrtim dallimet dhe veçantitë e tyre.

Ta kujtoj se edhe Hegeli para më se 200 vjetësh pati paralajmëruar vdekjen e artit, ndonëse fliste me admirim për kënaqësitë që i ofronte piktura holandeze e asaj kohe. Kurse, pas vdekjes (fizike) së Hegelit, u hap një periudhë e cila u cilësua shpesh si periudhë e shpërbërjes, madje edhe vdekjes jo vetëm e sistemit filozofik të Hegelit, por edhe e filozofisë në përgjithësi. Këtë vdekje të

filozofisë e shpallën së pari rrymat pozitiviste e scientiste përgjatë shekullit XIX: sipas tyre, me zhvillimin e shkencave të natyrës, në njërën anë dhe të shkencave mbi shoqërinë (sociologjia, fjala vjen), në anën tjetër, filozofia ka humbur fushën e vet të hulumtimeve e, me këtë, edhe vetë arsyen e ekzistimit të saj. Mirëpo, filozofia bashkëkohore e shekullit XX u dëshmuar se është një nga periudhat më të frytshme në historinë e filozofisë. Përveç mendimit të Heideggerit, janë filozofë të mëdhenj si Husserli, me filozofinë e fenomenologjisë, Gadameri e Ricoeur me hermeneutikën e tyre, Sartri me ekzistencializmin dhe me një ontologji të re, Derrida me dekonstruktimin e metafizikës, por edhe me analiza të thella mbi artet, Foucaultja me analizat e thella të botës bashkëkohore, Deleuze, Erich Fromm, Herbert Marcuse, Adorno, Horheimer, Habermas, Frege, Brentano e shumë të tjerë. Disa njohës të Heideggerit pastaj kanë cekur, po kështu, se ai i lexonte fort pak filozofët bashkëkohorë. Sipas gjykimit tim personal, gjithsesi, filozofia ende mund dhe duhet të ofrojë orientime për shoqërinë njerëzore, të krijojë bazamente për çështje kapitale të shoqërisë si vlera morale dhe kritike për njerëzit, me ç'rast shqyrtohen dhe rishqyrtohen realitetet tona.

Kanti orientohet me një pyetje themelore që pyet për mundësinë e moralitetit

Profesor, ka mendime, edhe nga vetë filozofët bashkëkohorë, se në filozofi po ndodhë një lloj rehabilitimi i brendshëm, me ç'rast po zhvillohen disa nëndisiplina të reja filozofike përmes të cilave po kërkohet krijimi i një qasjeje të re dhe një mendim të ri. Nëse jeni dakord me këtë, cili mund të jetë ky mendim?

KULLASHI: Keni plotësisht të drejtë. Llojshmëri e rrymave, e disiplinave filozofike dhe e çështjeve dhe temave me të cilat ato merren në periudhën bashkëkohore është rritur dukshëm. Këto disiplina dhe rryma të reja prodhojnë pyetje dhe qasje të reja, koncepte të reja ndaj problemeve dhe çështjeve të botës bashkëkohore, e cila është bërë shumë më e ndërlikuar se ato të periudhave të mëparshme.

Ta marr shembullin e *bioetikës*. Zhvillimet e shpejta të shkencave biomedikale dhe sfidat që i kanë shtruar për mendimin etik eksperimentimet mbi qenien njerëzore kanë ndikuar në krijimin e *bioetikës* si disiplinë e re në gjysmën e dytë të shekullit XX si dhe në bashkërendimin e analizave kritike shumëdisiplinore

(filozofi, shkenca shoqërore, mjekësi dhe biologji etj.). Njëherësh janë riaktivizuar edhe potencialet e koncepteve etike tradicionale me rimendimin e tyre përballë problemeve që i hap para nesh situata bashkëkohore. Është interesant të ceket se në këto kërkime pluridisiplinore nuk janë të rralla referencat tek etika e Kantit. Kjo nuk është e rastësishme. Nëse kujtesa jonë mbi çështjet etike mbetet e gjallë, atëherë do të na kujtohet se Kanti ishte filozofi i cili e shtroi në mënyrë rrënjësore çështjen "trascendentale", përkatësisht çështjet mbi kushtet dhe mundësitë e formimit të një dije mbi etikën. Të cekim këtu se karakteri radikal i *përmbysjes* që Kanti solli në historinë e mendimit mbi çështjet morale dhe etike, shfaqet edhe te pyetja mbi *mundësinë e pushtimit të veprimeve etike*, të aktualizimit të tyre, edhe nëse nuk kanë ekzistuar në të kaluarën. Pyetje kjo që përsiat mbi *mundësinë e prodhimit të veprimeve etike*, përtej moraleve ekzistuese dhe adeteve e zakoneve, si veprime të mira, të çliuara nga faktorë të jashtëm, që kanë të bëjnë me njeriun si njeri e jo thjesht për anglezin, gjermanin apo francezin. Në *Kritikën e mendjes praktike*, Kanti orientohet me një pyetje themelore që pyet për vetë *mundësinë e moralitetit*, mundësinë që një veprim të njeriut të mund ta cilësojmë si veprim të moralshëm apo të pamoralshëm. Derisa në traditën shumëshekullore të moralit dhe etikës kjo pyetje nuk shtrohet, por definohen *sisteme të ndryshme të vlerave morale* dhe bëhet fjalë për rrugët e arritjes së tyre, Kanti pyet se *në saje të çkafit ne mund të pohojmë se një veprim mund të quhet i moralshëm, si bëhet ai i moralshëm*. Është fjala për një pyetje që shënon përmbysje në historinë e gjatë të mendimit etik. Në librin tim *Filozofema*, por edhe në disa shkrime të paradokohshme e kam vënë në pah sa risinë që sjell etika e Kantit në modernitet, po aq edhe pertinencën e pyetjeve të tij mbi disa probleme etike dhe *etiko-politike* të shoqërisë së sotme.

Disa autorë pohojnë se një bashkëpunim i frytshëm i disa fushave kërkimore të sotme është dëshmuar edhe me hulumtimet rreth çështjes së dhuratës.

KULLASHI: Është e saktë. Problematika e *dhuratës*, e cila u zhvillua në veçanti brenda filozofisë, sociologjisë e antropologjisë bashkëkohore, është një dëshmi tjetër për frytshmërinë e bashkëpunimit midis filozofisë dhe disa shkencave shoqërore. Bronislav Malinowski, Marcel Maussi, Lévi-Strauss, Jacques Derrida dhe Georges Bataille, si dhe Paul Ricoeur, zhvilluan hulumtime të thella për këtë



JULIO CORTAZAR

Çka më pëlqen...

Çka më pëlqen nga trupi yt është seksi.
Çka më pëlqen nga seksi yt është goja.
Çka më pëlqen nga goja jote është gjuha.
Çka më pëlqen nga gjuha jote është fjala.

Përktheu: Maksim RAKIPAJ

temë, që duket tejet e veçantë, ndonëse hedh dritë në pikat thelbësore të një shoqërie dhe të një qytetërimi. Kështu, Maussi në *Ese mbi dhuratën* cek se dhurata iu përket të gjitha trajtave të jetës shoqërore, gjësedeve si dhe personave, realiteteve, si dhe mënyrave të qeniesimit. Ajo është një "fakt social total". Është mirë që kjo vepër u përkthye së voni në gjuhën shqipe.

Paul Ricoeur, një nga mendimtarët e shquar të fenomenologjisë dhe hermeneutikës, ka trajtuar, në hulumtimet e veta, temën e dhuratës, përmes ndriçimit të atyre *përvojave të pranimit* në historinë e njerëzimit, që nuk implikojnë dhunën dhe luftën. Shqyrtimin e teorive bashkëkohore filozofike, sociologjike dhe juridike, që trajtojnë raportet ndërindividuale e ndërgrupore, nga aspekti i pranimit të ndërsjellë (dashuria dhe afektiviteti, të drejtat juridike dhe respekti shoqëror), Ricoeur i thellon duke u mbështetur veçanërisht në hulumtimet antropologjike mbi dhuratën, mbi praktikën shoqërore të *këmbimit të dhuratave*, si moment i një politike të *pranimit reciprok simbolik*. Kjo e shpie Ricoeurin drejt një analize kritike të teorive mbi dhuratën te Marcel Mauss, Lévi-Strauss dhe Marcel Hénaf. Thënë shkurtazi, Ricoeur mendon se koncepti i filozofit e antropologut Marcel Hénaf ofron jo vetëm një konception më të thellë mbi dhuratën se paraardhësit e tij, por edhe një vepër vendimtare (*Le prix de la vérité, Çmimi i të vërtetës*, e botuar më 2002 nga Seuil, në Paris) në kërkimet mbi pranimin e ndërsjellë. Hénaf e zhvendos theksin e debatit antropologjik mbi dhuratën, prej relacionit midis dhënësit e marrësit të dhuratës, kah *reciprociteti* i këmbimit

midis protagonistëve, duke e emërtuar këtë operacion të përbashkët me shprehjen *pranim i ndërsjellë*. Është fjala për një tip të raporteve ndërnjerëzore që nuk i takojnë as rendit të këmbimit të të mirave materiale (rendit ekonomik), e as nuk janë shprehje e ndihmës altruiste (rendit etik), por shprehjeve simbolike të reciprocitetit. Hénaf shkoqitë krijimin dhe mbajtjen e lidhjeve mes njerëzve përmes një procedure simbolike të pranimit publik e reciprok të individëve dhe grupeve, si të ngjashëm me veten. Dhënia e dhuratës është sfidë dhe ngashënjim që i drejtohet tjetrit për të hyrë në një relacion, që përmban miqësinë e respektin e ndërsjellë. Në këtë relacion gjendet edhe domethënia e tretë e fjalës "reconnaissance", mirënjohja ndaj një gjesti a veprimi bujar.

Do të shtoja, sa iu takon degëve të ndryshme të filozofisë, se sot janë bërë më komplekse e më të begatshme edhe kërkimet filozofike mbi ligjërimin, mbi letërsinë, mbi dramën, mbi poezinë, mbi pikturën, mbi filmën etj.

(Intervistën e plotë mund ta lexoni në numrin e tetë të revistës "Akademia" që sapo ka dalë nga shtypi. Revistën e gjeni: në librarinë "Artini", "Dukagjini" dhe në redaksinë e gazetës "Epoka e re" në Prishtinë. Të drejtën e botimit: "Akademia" dhe shtëpia botuese "Armagedoni". Po ashtu, dy vazhdimet e mëparshme të kësaj interviste mund t'i lexoni në formatin pdf të gazetës Epoka e re", duke çukitur në vjeggjën: <https://www.epokaere.com>)

Sharlatanët

Dihet se filmi gjithmonë është konceptuar si mjet i fuqishëm i propagandës shtetërore. Prandaj, gjatë komunizmit - si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovën pjesë të Federatës jugosllave - veprat kinematografike nuk duhej assesi të binin ndesh me ideologjinë. Në njërin anë të kufirit shqiptar-shqiptar ishte Njeriu i Ri, e te tjetri ishte ideologjia e vëllazërim-bashkimit. E vërteta për hallet e shqiptarit... askund!

Gjatë demokracisë në Shqipëri dhe gjatë lirisë në Kosovë, kauzat (bardhezi) komuniste u zëvendësuan me disa të tjera, po ashtu, të rrejshme, që qytetarit të rëndomtë prapë gjë të hairit nuk po i ofrojnë. Kjo kryesisht për faktin se trendi i themelimit të Organizatave vendore Joqeveritare (OJQ) nuk bazohej në parimin për aktivitetet qëllimira e mbi baza vullnetare, por te modelet më të këqija të Afrikës e të Azisë, nga të cilat dobi kishin veç udhëheqësit e atyre organizatave. Kështu, si rrallëkund në Evropë, "artistët" shqiptarë u bënë biznesmenë dhe, për të vjelë me çdo kusht fonde, shumica e skenaristëve, e dramaturgëve dhe e regjisorëve (në film e në teatër), për t'u dukur kinse kozmopolitë që merrem me probleme "globale", krijuan vazhdimisht histori me shkeljen e të drejtave të grave, me islamizmin radikal, me homofobinë, me nacionalizmin e me racizmin... duke i paraqitur si problemet më të mëdha të shoqërisë shqiptare e jo, p. sh., papunësinë, izolimin apo mungesën e perspektivës që i vuajnë shumica në shoqëri, përfshirë edhe viktimat eventuale të "kauzave" që u cekën më lart. Në rastet e tilla, filmat nuk janë as të mençur e as me zemër - siç do të kërkonte regjisorin i madh japonez, Akira Kurosawa. Prandaj, aktori Alfred Trebicka, kur flet për kinemanë si art kompleks që kërkon jo vetëm arsimim specifik, por edhe një njohje me fushat e tjera që kanë lidhje të drejtpërdrejta ose jo me artin, shprehet se "tregu i kinemasë shqiptare është i mbushur me sharlatanë", ndërsa ata që bëjnë filma "kanë kurajën e të paafitit ose kurajën e amatorit".

Çuditërisht, si dikur ashtu edhe sot, për mungesë suksesi shqiptarët rëndomë i fajësojnë institucionet shtetërore si dhe buxhetin që ndahet për filma. Duke mos u pajtuar me ankesat e tilla, regjisorin skocez Saul Metzstein, dikur me ironi ua ka dhënë këtë këshillë "kineastëve" e "producentëve" kosovarë: "Mos provoni filma në temat e ngjashme, si 'Lord of the Rings' (Kyezoti i unazave)". Sepse, buxheti nuk është problem i madh, sa janë dështimet në zinxhirin krijues që dëmtojnë edhe idenë e mirë; ajo paafësi për të menaxhuar si duhet të gjitha hallkat e filmit si art kompleks.

Se buxheti nuk është problem, dëshmi për këtë janë edhe këta filma kultë: *El Mariachi* (Mariachi, 1992) që ka kushtuar 7 000 dollarë; *Eraserhead* (Koka e gomës, 1977) që ka kushtuar 10 000 dollarë,

Paranormal Activity (Aktivitetet paranormale, 2007) - 11 000 dollarë; *Clerks* (Shitësit, 1994) - 28 000 dollarë... Për krahasim, për filmin *Kukumi* (2005), me regji të Isa Qosjes e me skenar të Mehmet Krajës, veç nga Ministria e Kulturës e Kosovës thuhet se janë ndarë 400 mijë euro - më shumë se buxheti i filmit *Forushande* (Shitësit, 2016) i regjisorit Asghar Farhadi, fitues i çmimit Oscar si Filmi më i Mirë i Huaj më 2017. Ndërkaq, kur është fjala te teknika, regjisorin iranian Jafar Panahi, me celular *iPhone 4* e me kamera të lira të llojit *GoPro*, duke sfiduar, po ashtu, censurën dhe ndalesat e rrepta të regjimit, realizoi filma të vlerësuar që shpërblehen në festivalet prestigjioze të botës. Sepse, ekipet e tamam artistëve synim kanë artin, për çka vuajnë dhe sakrifkohen, e jo zvatjen dhe përvetësimin e parasë publike.

Ndryshimi i madh

Lulëzimi në vitet e fundit i kinemasë iraniane, por edhe asaj libaneze, po tërheq edhe interesimin e botës për temat e vogla të njerëzve të rëndomtë (siç bënë gjatë komunizmit, regjisorët polakë të Kinemasë së Ankhthit Moral). Por, kritiku i filmit në ditoren *The Guardian*, Peter Bradshaw, shprehet se çmimet Oscar të vitit 2020 po paralajmërojnë ndryshime të mëdha edhe në industrinë e Hollivudit. Kjo deklaratë u dha pasi filmi *Gisaengchung* (*Parazitët*, 2019), i regjisorit jug-korean Bong Joon-ho, u nominua për gjashtë çmime Oscar, ndërsa i fitoi katër kryesoret: Filmi më i Mirë, Regjia më e Mirë, Skenari më i Mirë dhe Filmi më i Mirë i Huaj. Këto çmime jo vetëm që nxitën dhe shtuan interesimin e botës për ta njohur kinematografinë e Koresë së Jugut, por vunë në pah rëndësinë e trajtimit të problemeve të përditshme që shqetësojnë shoqërinë moderne - në këtë rast të metat dhe të ligat e sistemit kapitalist. Në një version ndryshe të filmit *Ikiru* (Të jetosh, 1952) të Kurosawas, për dramën ekzistencialiste të njeriut në tranzicionin shoqëror. Tema këto që janë sa vendore, aq edhe universale.

Për *Parazitët*, Joon-ho ka thënë se është një komedi pa klounë, një tragjedi pa keqbërës. Ndërkaq, kur është pyetur për buxhetin, është shprehur se ishte sa një pesta e buxhetit të filmit *Okja* (*Okxha*, 2017), që është bërë në koproduksion me amerikanët e që ka kushtuar 50 milionë dollarë. *Parazitët* nga shitjet i ka fituar rreth 235 milionë, por ka kushtuar 10 milionë - shumë kjo relativisht e vogël për filmat e shteteve të zhvilluara, sidomos për një shtet si Koreja e Jugut që ka buxhet prej 434.4 miliardë dollarëve e ku, për vitin 2020, hiç më pak se 4.9 miliardë dollarë i janë ndarë veç Ministrisë së Kulturës, Sportit dhe Turizmit.

Megjithatë, buxheti nuk është

faktori që i ka shtyrë kritikët dhe adhuruesit e kinemasë të japin vlerësime pozitive për filmat si *Okxha* dhe *Parazitët*. Por, është ideja, pastaj ajo aftësia e duhur dhe qasja e ndershme për ta zhvilluar e çuar ku duhet atë ide që thjesht është... njerëzore.

Edhe nëse abstrahohen çmimet e shumta të fituara, filmi *Paraziti* është shumë i veçantë sepse në të shkrihen zhanret; është një film me shumë shtresa, me shumë zhvillime e shumë transformime, e ku në fund gjithçka përmbysset. Në të është jeta e mundshme e secilit, qoftë shqiptar apo jug-korean... Transformimet dhe përmbysjet i përjetuan edhe Mehdi Frashëri, Et'hem Toto, Ahmet Zogu e Petro Marko, sepse personaliteti - pos bazës biologjike - varet edhe nga rrethi, nga faktorët shoqërorë. Pastaj, te *Paraziti* shpresa nuk shuhet. Ajo jeton si një ogur për ndryshime. Njëjtë kanë vepruar edhe katër shqiptarët e sipërpërmendur, e shumë të tjerë, sepse janë nxitur sa prej emocioneve dhe bindjeve, aq edhe nga shpresa të cilën e kanë besuar e për të cilën kanë jetuar. Prandaj, vlejnjë të studiohen, për të njohur jo veç një pjesë të historisë shqiptare, por edhe kauzalitetin, Jinin dhe Jangun...

Edhe...?

Studimi dhe kërkimi i tillë për dramën reale, individuale apo shoqërore duhet të jetë model për çdo skenar filmi. Për çfarëdo ideje, për cilindo personazh apo cilëndo kohë. Si kërkimi i guximshëm për të vërtetën (alias artin) tek një nga filmat më të mirë në historinë e kinematografisë - *Citizen Kane* (*Qytetari Kane*, 1941) i regjisorit amerikan Orson Welles, që flet për të vërtetën relative dhe për ngritjen e rënien e një magnati medial që beson se e zotëron fjalën dhe të vërtetën; apo te filmi *Szlowiek z marmuru* (*Njeriu i mermertë*, 1977) - i regjisorit polak Andrzej Wajda, ku trajtohet dogma komuniste, proletariati veç si vegël e sistemit dhe dështimi i gënjeshtëris për Njeriun e Ri sovjetik (që personifikohet përmes një punëtori "model" të kohës së stalinizmit mizor në Evropën Lindore).

"Për ta bërë një film, kjo është gjë e lehtë; për ta bërë një film të mirë, kjo është luftë. Për ta bërë një film shumë të mirë, kjo është mrekulli", ka thënë regjisorin i njohur meksikan Alejandro Gonzalez Inarritu, i cili me filmin e tij *Birdman* (*Njeriu zog*, 2014), më 2015 i fitoi tri çmimet kryesore Oscar. Ndërkaq, kur filmi është i keq, aktori Jack Black ka thënë se është një dëshirë që plasimi i tij të bëhet në heshtje, të mbahet sekret si sëmundjet seksualisht të transmetuara. Por, për rastin e shqiptarëve kjo sikur nuk vlen.



AFRIM DEMIRI

Unë dhe vdekja

Unë dhe vdekja ndiqemi marrëzisht brenda katrorëve magjikë në lojën e kurtheve të padukshme Herë dalim përballë e herë strukemi pas maskash si gjahtarë tinëzarë Unë dhe ajo, herë Mbret e Mbretëreshë e herë kali e top vendnumërojmë gjatë në pritje të gjahut plot kob Unë i bardhë si borë ajo e zezë pis bëjmë leqe, bardh e zi fshihemi mes figurave si mes lisave të pyllit të shpëtimt në kërkim të një jete në të sosur Si vdekje e vërtetë përtej kurtheve më sheh dhe më gjuan me Shu, Sheh, Shah E unë e ndiej se po bie, ah në mat si të bie nga i shtati kat Të lodhur nga ndjekja palosemi të dy në kuti ashtu siç paloset një ditë në gjirin e një nate derisa dielli e fillon lojën përsëri

Ata, andej e këndej kufirit, bashkë me dy QKK-të e tyre goxha dubioze (Qendra e Kinematografisë Kot alias Qendra Kinematografike e Kosovës/Qendra Kombëtare e Kinematografisë), kënaqen sa për të thënë që e bënë një film, një serial (apo një shfaqje teatri). Pastaj, duke e luajtur rolin e zëdhënësit vigjilent të dëlirit të tyre të madhësisë, nuk hezitojnë të krijojnë insinuata me komunikatat dhe insistimin për të qenë lajm me pjesëmarrjen dhe triumfin (e injorancës) nëpër festivalet e parëndësishme e shpesh inekzistente...

Për fund është mirë të përmendet një "proverb" boshnjak. Për shkak të terrenit të përshtatshëm që Bosnja kishte për luftën e partizanëve gjatë Luftës së

Dytë Botërore, komunisti hebre që veten e mbante për jugosllav, Moshë Pijade, me një rast thotë: "Q... shtetin që s'ka Bosnje". Më vonë, thënia e tij u bë simbol i krenarisë, i mburrjes, patriotizmit e, madje, humorit. Kështu, kur më 2002 filmi *Ni ija zemlja* (*Toka e askujt*) e fiton çmimin Oscar si Filmi më i Mirë i Huaj, regjisorin Danis Tanović shprehet: "Q... shtetin që s'ka Oscar"!

E çfarë do të thoshin Mehdi Frashëri, Et'hem Toto, Ahmet Zogu apo Petro Marko, nëse nga kalkulancat e profitit material do të bëhej një film për jetën e tyre? Për kohën e tyre? Apo për trashëgimtarët e tyre?

Përgjigjen e di... Tanović!

(Marrë nga numri i tetë i revistës "Akademia" që sapo ka dalë nga shtypi)

E jashtëzakonshme

Burri nga Vietnami me flokë të gjata pesë metra, nuk i ka larë që 80 vjet

Ndonëse periudha e izolimit i detyroi burrat nëpër botë që t'i rrisnin flokët më shumë sesa zakonisht, asnjë gjatësi e flokëve të tyre nuk mund të krahasohet me atë të Nguyen Van Chien. Burri 92-vjeçar nga rajoni jugor i Vietnamit, Mekong Delta, krenohet me gjatësinë e flokëve pesë metra, të cilat nuk i ka prerë, larë e as krehur për gati 80 vjet, shkruan "The Guardian".



BARSOLETA E DITËS



Dy pacientë të shtrirë në spital, flasin me njëri-tjetrin:

- Çfarë të gjeti?
- Nuk i bleva gruas veturë. Po ty?
- I bleva gruas veturë.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

FOTO E DITES



Natyre e bukur në Liqenin e Breznës



E rrallë

Shkuan për pushime, dy adoleshentët zbulojnë thesarin me monedha ari "Lopët fluturuese" shijojnë teknologjinë e re të transportit

Gjatë pushimeve të verës dy adoleshentë izraelitë zbuluan qindra monedha ari të cilat datojnë 1 100 vjet më parë. Monedhat ishin të vendosura në një kavanoz argjile dhe ishin të groposura thellë në tokë në Yavne, në Izraelin qendror. Robert Kool, një ekspert i monedhave, tha se

këto monedha datojnë që nga fundi i shekullit të nëntë atëherë kur rajoni ishte nën kontrollin e Kalifatit Islamik Abasid, një dinasti që sundonte territoret nga Algjeria e ditëve moderne dhe deri në Afganistan. Gjithsej ishin 425 monedha prej ari të pastër 24 karat dhe peshonin 845 gramë.

 <p>DASHI Nuk keni përse të ndiheni në faj për dikë që po kalon një periudhë më të vështirë se ju. Çfarëdolloj pengesash do të kaloni.</p>	 <p>DEMI Mund të mërzhiteni nga veprimet e dikujt, por kjo nuk do të ndryshojë asgjë. Mënyra më e mirë për t'u përballur me këtë situatë është që ta lini të rrjedhë natyrshëm.</p>	 <p>BINJAKËT Dikush që do të njihni përmes shoqërisë, mund të kthehet në një person të rëndësishëm përgjatë muajve që do të vijjnë.</p>	 <p>GAFORRJA Është mirë të flisni me partnerët e kolegët, t'ua bëni atyre të ditur se çfarë mendoni, përpara se të jetë shumë e vështirë për t'i ndryshuar gjërat.</p>	 <p>LUANI Javët e fundit e keni lodhur veten më shumë se duhet dhe, pavarësisht prej përfitimeve të dukshme, mos harroni se jeni njeri.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Nëse nuk e mbaroni dot një detyrë pa u lodhur më shumë sa duhet, atëherë hiqni dorë dhe shpenzoni energjinë për diçka më të mirë.</p>
 <p>PESHORJA Nuk ka rëndësi sa gjëra të këqija ndodhin në botë, ka ende gjëra pozitive dhe shumë njerëz të mirë, ndaj mos u dëshpëroni.</p>	 <p>AKREPI Do ta keni të vështirë që të bindni dikë se ajo që po bëjnë është jo vetëm e gabuar, por e dështuar.</p>	 <p>SHIGJETARI Nëse planet tuaja nuk janë të njëjta me agjendën e atyre që bashkëpunoni, mos kini frikë t'ia bëni të ditur se nuk do ta ndiqni rrugën e tyre.</p>	 <p>BRICJAPI Po mendoni shumë për dikë kohët e fundit dhe kjo po kthehet në obsesion. Duhet ta hiqni nga mendja dhe t'i riktheheni normalitetit.</p>	 <p>UJORI Mos e shpenzoni kohën duke diskutuar me njerëz që nuk do të bien kurrë dakord me ju, edhe nëse ia provoni që ajo që po thoni është e vërtetë.</p>	 <p>PESHQIT Me afrimin e hënës së re do të përballeni me shumë sfida e mundësi të reja, ndaj duhet të jeni të gatshëm të adaptoheni.</p>





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82**

Llapi, me dyshen Januzi - Haliti, mbyll afatin kalimtar

Llapi i Tahir Batatinës ka bërë një goditje të madhe të enjten, pasi ka transferuar nga Prishtina dyshen Ahmed Januzi - Ahmet Haliti. "Me ardhjen e Ahmed Januzit dhe Ahmet Halitit, KF Llapi edhe zyrtarisht e ka përfunduar merkaton verore dhe tashmë ndihet i kompletuar dhe i sigurt para fillimit të edicionit të ri të Superligës", thuhet në njoftimin e Llapi



EPOKA E RE **Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 27 GUSHT - Skuadra e Llapit ka qenë ndër klubet që ka bërë më së shumti transferime në këtë afat kalimtar. Klubi nga Podujeva të enjten ka prezantuar dyshen e Prishtinës, Ahmed Januzi dhe Ahmet Haliti, si dhe ka njoftuar se ky afat kalimtar ka përfunduar. "Me ardhjen e Ahmed Januzit dhe Ahmet Halitit, KF Llapi edhe zyrtarisht e ka përfunduar merkaton verore dhe tashmë ndihet i kompletuar dhe i sigurt para fillimit të edicionit të ri të Superligës. Dyshja Januzi e Haliti në edicionin e fundit ishin pjesë e Prishtinës, me të cilën arritën ta fitonin Kupën e Kosovës dhe nga sot edhe zyrtarisht do të jenë pjesë e Llapit. Që të dy nënshkruan kontratë njëvjeçare me klubin", thuhet në njoftimin e Llapi. Sipas njoftimit të klubit nga Podujeva, në projektin madhor të trajnerit të Llapit, Tahir Batatina, dyshja Januzi - Haliti shihen si të domosdoshëm për skuadrën. Ahmed Januzi është i njohur për llojshëm, pasi ishte golashënuesi më i mirë i Llapit që kishte

arritur të realizonte 13 gola dhe 5 asistime gjatë edicionit 2018/19, derisa në edicionin e fundit Januzi ishte pjesë e Prishtinës, me të cilën arriti ta fitonte Kupën e Kosovës, duke qenë kyç edhe në këtë skuadër, pasi ishte golashënuesi më i mirë i saj, me 15 gola e 6 herë asistues. Ndërsa Ahmet Haliti është lojtar kampion. Përvoja e tij e madhe dhe stabiliteti që i jep mbrojtjes kur luan, e bëjnë atë ndër qendërmbrojtësit më të mirë në vend. Haliti është paraqitur me mjaft sukses në skuadrat elitare në Kosovë e Shqipëri. Ka qenë pjesë e KF Besianës, KF Hysit, KS Besa e Kavajës, FC Hajvalia, FK Bylis Ballsh, FC Feronikeli e së fundmi tek FC Prishtina, me të cilën fitoi Kupën e Kosovës në dy edicione 2017/18 dhe 2019/20.

FC Prishtina konfirmon largimin e pesë futbollistëve

Skuadra fituese e Kupës së Kosovës në futboll, FC Prishtina, ka njoftuar se në këtë afat kalimtar janë larguar pesë futbollistë, përfshirë edhe kapitenin Armend Thaqi.

"Janë larguar Armend Thaqi, Ahmed Januzi, Diar Miftararaj, Ahmet Haliti dhe Meriton Korenica. Skuadra i falënderon për kontributin e dhënë, sidomos në një edicion kaq të vështirë për klubin, pas rastit të ngjarjeve në Gjibraltar. Klubi ju kërkon falje nëse jeni ndierë të lënë pas dore, ju falënderon për ditët e kaluara në FC Prishtina dhe ju uron sukses në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e Prishtinës.

Korenica prezantohet te Ballkani

Sulmuesi Meriton Korenica ka zyrtarizuar largimin nga Klubi i Futbollit Prishtina. Në një shkrim publikuar në "Facebook", Korenica ka falënderuar klubin e Prishtinës, ndërsa s'ka bërë me dije se ku do ta vazhdojë karrierën. "Fantazisti Meriton Korenica nga sot i bashkohet FC Ballkanit. Tani e tutje fantazive të tij me topin do t'i gëzohen dhe duartrokasin fansat e klubit tonë. Mirë se vjen, Korenicë! Kemi punë për të bërë. Na priftë e mbara!", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

SHKURT

Vojvoda prezantohet te Torino

Mbrojtësi i Përfaqësueses së Kosovës në Futboll, Mërgim Vojvoda, i është bashkuar Torinos nga Standard Liege, njofton klubi i Serisë A. Vojvoda ka nënshkruar kontratë katërvjeçare me Torinon, e cila do ta mbajë atë në Serinë A deri në verën e vitit 2024. "Klubi i Futbollit Torino njofton me kënaqësi se i ka siguruar shërbimet e lojtarit të Standard Liege, Mërgim Vojvoda. Mbrojtësi ka nënshkruar kontratë katërvjeçare", thuhet në njoftimin e Torinos. 25-vjeçari i ka bërë 22 paraqitje për "dardanët", me të cilën e ka shënuar një gol.

Drenica ia beson postin e trajnerit Ramës

Fadil Rama do të jetë trajner i Drenicës për edicionin 2020/21. Ai ka arritur marrëveshje me klubin kuqezi nga Skenderaj për ta drejtuar Drenicën edhe në kampionatin e ri. Trajneri Rama e mori drejtimin e Drenicës pak javë pa përfunduar Superliga dhe arriti që ta sigurojë mbijetesën në elitë.

Leipzig heq dorë nga transferimi i Rashicës

Reprezentuesi i Kosovës, Milot Rashica, nuk do të transferohet te gjermane RB Leipzig, pasi kjo skuadër nuk ka arritur marrëveshje rreth çmimit të Rashicës me Werder Bremenin. Leipzig kishte ofruar 15 milionë euro, plus tri milionë euro në formë bonusesh, por që kjo ofertë nuk është pranuar nga Werderi. Skuadra aktuale e Rashicës ua ka bërë të qartë klubeve të interesuara për lojtarin se kërkon vetëm 25 milionë euro dhe asnjë më pak. Rashica mund të transferohet në Premier Ligë, pasi interesim për shërbimet e tij kanë treguar disa klube.

Challandes vazhdon me Kosovën

PRISHTINË, 27 GUSHT - Bernard Challandes do të vazhdojë t'i prijë Përfaqësueses së Kosovës deri në vitin 2022. Marrëveshja e re është arritur të enjten në takimim që kryetari Agim Ademi së bashku me sekretarin e

përgjithshëm Eroll Salihu e kanë zhvilluar me trajnerin zviceran, e ku palët u pajtuan që ta vazhdojnë rrugëtimin e përbashkët edhe për dy vjet. "Kontrata e re është për periudhën 2020-2022. Deri te marrëveshja e re erdhi si

rezultat i punës së mirë dhe sukseseve të arritura të 'dardanëve' në periudhën 2018-2020, derisa me punën e trajnerit zviceran kanë qenë të kënaqur të gjithë. Në anën tjetër, edhe Challandesi është i kënaqur me punën,

kushtet dhe gjithçka që ofron FFK-ja. Tani përqendrimi është te dy ndeshjet e radhës kundër Moldavisë dhe Greqisë, me shpresë dhe besim për suksese të reja", thuhet në njoftimin e FFK-së.



Drita i drejtohet Gjykatës së Arbitrazhit Sportiv

GJILAN, 27 GUSHT - Skuadra e Dritës do të apelojë në Gjykatën e Arbitrazhit Sportiv (CAS) përjashtimin nga Liga e Kampioneve pas rregullave të reja të UEFA-s gjatë pandemisë së koronavirusit. "Bardhekaltrit" besojnë se

humbja në tavolinë ndaj ekipit të Linfieldit (3:0), ishte e padrejtë dhe kështu janë optimistë që do të marrin një dëmshpërblim të majmë. UEFA në koordinim me autoritetet e Zvicrës kishte anuluar takimin për shkak se

dy futbollistë të Dritës kishin dalë pozitivë në testin për Covid-19. Drita ka angazhuar avokatin zviceran Luca Tettamanti, i cili do t'i ndjekë procedurat për ta apeluar rastin. Në një prononcim për "Associated Press", Tottenham

ka theksuar se është duke proceduar me fakte. "Ne jemi duke proceduar rastin bazuar në fakte", deklaroi Tettamanti për "AP". Ndërkohë, Drita do t'i vazhdojë garat në kualifikimet e Ligës së Evropës, ku është në pritje të kundërshtarit.



Mehmeti rrëfen si u kthye nga Londra për ta shpallur Trepçën kampione

PRISHTINË, 27 GUSHT - Një nga basketbollistët më cilësorë në vendin tonë pa dyshim ishte Artan Mehmeti. Basketbollisti nga Mitrovica ishte idhull për tifozët e Trepçës, por gëzonte respekt në tërë Kosovën. Në një intervistë për faqen zyrtare të FBK-së, Mehmeti ka treguar se si filloi të merret me basketboll, duke braktisur futbollin, gjithashtu si u kthye nga Londra për ta shpallur Trepçën kampione. Ai flet edhe për kundërshtarin më të vështirë që është ballafaquar.



Si vendose të merresh me basketboll?

Mehmeti: Ka qenë ndeshja e All-Star Game e vitit 1989 kur e kam parë për herë të parë "Air Jordanin" duke luajtur dhe në çast gjithçka ndërroi tek unë. Prej futbollistit mesfushor kreativ, kalova në basketboll.

Cili ka qenë idhulli yt në fëmijëri?

Mehmeti: Si shumica e fëmijëve në atë kohë, edhe unë kisha dëshirë të bëhesha si "Air Michael Jordan".

Cili ka qenë trofeu më i rëndësishëm për ty dhe pse?

Mehmeti: Trofeu më i rëndësishëm për mua është i sezonit 2000/2001 me Trepçën, ku unë në atë kohë kam lënë Londrën për t'u kthyer në klubin e zezës, aty ku më është plotësuar ëndrra të luaja para 4 500 shikuesve dhe për asnjë çast nuk jam penduar që jam kthyer

dhe kam vazhduar t'i jetësoj ëndrrat e mia në basketbollin e Kosovës.

Cilën ndeshje nuk mund ta harrosh asnjëherë?

Mehmeti: Ka shumë ndeshje që nuk i harroj, sidomos finalen e shumta të fituara, por edhe ato që i kam humbur. Ndoshta loja kundër Pejës në Pejë kur pas një disavantazhi prej 16-pikësh në çerekun e fundit arrijmë të fitojmë në një fund dramatik.

Cili ka qenë kundërshtari më i vështirë që je ballafaquar?

Mehmeti: Samir Shaptahoviq. Kur ishte i ri dhe unë në perëndim të karrierës. Ishte si "Pitbull". Problem ishte ta kaloja mesin e fushës prej tij. Vetëbesimi i tij ishte në qiellin e shtatë. Superbasketbollist, por djalosh edhe më i mirë.

Sa të mungon basketbolli dhe

atmosfera nga koha kur ke luajtur?

Mehmeti: Basketbolli më mungon shumë. Gjithçka rreth basketbollit profesionist më mungon, duke filluar prej stërvitjeve dy herë në ditë, adrenalina para derbeve më mungon shumë, atmosfera e publikut kur thërrisnin emrin tonë. Më mungojnë bashkëlojtarët. Edhe pse përpiqem ta kompensoj me basketboll për qejfi me shokë edhe tash dy herë gjatë javës.

Cili është mesazhi për lojtarët e rinj që duan të merren me basketboll?

Mehmeti: Mesazhi im është që t'i ndjekin ëndrrat e tyre. Basketbolli është sport shumë i mirë. Sporti në përgjithësi është shumë fitimprurës, duke filluar prej shëndetit, shoqërisë, pse jo edhe nga ana materiale, nëse bëhen sportistë kulminantë.

Superliga fillon me derbin Drita - Llapi

PRISHTINË, 27 GUSHT - Në selinë e Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), në prani të Komisionit të Garave dhe përfaqësuesve të klubeve, është bërë tërheqja e shortit për kampionatin e ri 2020/21 në Superligë. Fillimisht të pranishmit në emër të kryetarit Agim Ademi i përsëriti kryetari i Komisionit të Garave, Abdyl Bellopoja, i cili uroi klubet



për një edicion të mbarë teksa i njoftoi edhe për ndryshimet në sistemin e garave në elitë, që sivjet do të zhvillohet me 36 xhiro me sistem të katërfishtë. Ndërkohë, në bazë të tërheqjes së shortit, në xhiron e parë që planifikohet të nisë më 12 shtator, do të takohen: Drita - Llapi, Trepça'89 - Arbëria, Prishtina - Drenica, Besa - Ballkani, Feronikeli - Gjilani.

SHKURT

Joshua, Fury: Do të t'i thyej turinjtë

Anthony Joshua e ka paralajmëruar bashkatdhetarin e vet, Tyson Fury, se do ta mposhtë me nokaut brenda gjashtë raundeve në përballjen e tyre për titullin e kampionit të padiskutueshëm të botës në kategorinë e rëndë. Rivalët britanikë kanë rënë në ujdi për kushtet financiare të dy meçeve mes vete në të ardhmen. Por para se të arrijnë këtu, të dy, edhe Joshua edhe Fury duhet t'i fitojnë meçet e veta përkatëse kundër Kubrat Pulev dhe Deontay Wilder. Nëse e kalojnë këtë pengesë, atëherë Joshua dhe Fury do të luftojnë për titullin e boksierit më të mirë në botë në kategorinë e rëndë. "Kam shumë respekt për të, sepse është njeri i mirë familjar dhe boksier i mirë por, në anën tjetër, dua t'ia thyej turinjtë", ka thënë Joshua.

Ai parashikoi se do ta nokautojë Furyn brenda gjashtë raundeve të para. "E di se do ta nokautoj në gjashtë raundet e para. Unë kam pasur karrierë më të shkurtër se ai, prandaj jam më i freskët", ka shtuar ai. Fury do të duhet ta mbrojë titullin në WBC kundër Wilderit në fund të këtij viti apo në fillim të vitit 2021.

Joshua, ndërkohë, do të përballlet me Pulevin dhe shpreson në luftë me Fury pastaj. Joshua është kampion aktual në WBA, IBF, WBO dhe IBO.

Milani e rikthen Bakayokon, afër marrëveshjes edhe me Diazin

Mesfushori Tiemoue Bakayoko është afër rikthimit në skuadrën e Milanit, pasi Chelsea ka dhënë pajtimin që ai të huazohet me të drejtën e blerjes. Francezit mund t'i bashkohet edhe Brahim Diaz, pasi klubi kuqezi dhe Real Madridi janë drejt marrëveshjes për huazim me të drejtë blerje dhe tani fjala e fundit i takon futbollistit.

Pogba dhe Ndombele mungojnë te Franca, shkak Covid-19

Një kampion bote pozitiv me Covid-19. Mesfushori Paul Pogba është infektuar dhe nuk do të jetë me kombëtaren e tij në ndeshjet e shtatorit. Ai do të zëvendësohet nga Eduardo Camavinga. Një tjetër lojtar i Francës që ka dalë me koronavirus është edhe mesfushori i Tottenhamit, Tanguy Ndombele. Ai është izoluar dhe për 14 ditë do të qëndrojë në karantinë. Kështu shtohet numri i futbollistëve të prekur nga Covid-19. Mediat në Angli kanë raportuar sot se 8 futbollistë të Chelseas dyshohet se janë infektuar me koronavirus.

Gjashtë lojtarë të Chelseat infektohen me Covid-19

Sezoni i ri nis në mënyrën më të keqe të mundshme për skuadrën e Chelseat. Gjashtë futbollistë janë infektuar me koronavirus te skuadra e Bluve të Londrës dhe duhet të qëndrojnë për 14 ditë në vetizolim duke humbur ditët e para të përgatitjeve. Mason Mount, Tammy Abraham, Christian Pulisic dhe Fikayo Tomori janë në vetizolim, sipas të gjitha rregullave, pasi u infektuan gjatë pushimeve në Mykonos, në Greqi. Edhe futbollistët e tjerë Jorginho, Ross Barkley, Emerson dhe Michy Batshuayi nuk do të jenë të gatshëm për trajnerin Frank Lampard në ditët e para. Gjashtë prej tyre, sipas "Daily Mail", janë infektuar, ndërkohë që dy janë mbajtur në izolim për shkak të kontakteve të ngushta me të infektuarit.

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
Komuna e Dragash - Municipality of Dragash
Direktorati për Arsime dhe Kulturë
Direktorijati za Prosvetu i Kulturu

Nr. Br. 13/454
27.08.2020
Dragash - Dragaš

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

KONKURS- plotësues

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020/2021.

SHFMU " Fetah Sylejmani " Dragash
Mësimi në gjuhën boshnjake

1. Një mësimdhënës për mësim klasor në Dragash (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)
2. Një mësimdhënës i historisë (10 orë)

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj;
- Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës , duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar;
- Certifikata që nuk jeni nën hetim;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2020, por në varësi të lirimt real të vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk ju kthehet kandidatëve.

Datë: 27.08.2020
Dragash

Drejtori i DKA-së
MSc. Vloran Cenaj

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
Komuna e Dragash - Municipality of Dragash
Direktorati për Arsime dhe Kulturë
Direktorijati za Prosvetu i Kulturu

Nr. Br. 13/453
27.08.2020
Dragash - Dragaš

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine Dragaš/Dragas Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM

Në bazë të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit mbi Punën në Republikën e Kosovës, nr.03/L-212, nenit 5 të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr.10/2018 të datës 20.07.2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ nr.05/2015- normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, vendimin e MASHT nr.232/01B, vendimin e MASHT nr.231/01B të datës, 04 Gusht 2015, kërkesën nga MASHT ref.2-2955 të datës 01 Korrik 2016. Drejtoria Komunale për Arsim në Dragash, shpall:

KONKURS- rishpalljet

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për arsimin parafillor, fillor të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë të Komunës së Dragashit për vitin shkollor 2020/2021.

SHFMU " Shaban Shabani " Llopushnik

1. Një mësimdhënës për mësim klasor në Pllavë (deri sa punëtorja të kthehet nga pushimi i lehonisë)

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit (merret në DKA ku dorëzohen aplikacionet me dokumentet tjera përkatëse.);
- Dokumenti personal (kopja e letërnjoftimit ose pasaportës);
- Diploma duhet të jetë e vërtetuar nga origjinali, në të kundërtën nuk merret si valide (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj;
- Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet jashtë Republikës së Kosovës , duhet të sjellin diplomën e nostrifikuar;
- Certifikata që nuk jeni nën hetim;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2020, por në varësi të lirimt real të vendit të punës në IEAA (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Konkursi mbetet i hapur **8 ditë** nga data e publikimit në mjetet e informimit.

Vërejtje: Dokumentacioni i kompletuar për konkurrim nuk ju kthehet kandidatëve.

Datë: 27.08.2020
Dragash

Drejtori i DKA-së
MSc. Vloran Cenaj

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
Kuvendi Komunal Dragash - Skupština Opštine Dragaš - Municipality of Dragash
Drejtoria Komunale për Arsim - Direktorijati za Obrazovanje

Nr.Br 13/454
Data 27.08.2020

Na osnovu Zakona o Preduniverzitetskom Obrazovanju Republike Kosova br. 04/L-032, člana 8 Zakona o Radu Republike Kosova br. 03/L-212, člana 5 Zakona o Obrazovanju u Opštinama Republike Kosova br.03/L-068, Administrativno Uputstvo (MONT) br.10/2018 od 20.07.2018 o normativu o stručnom osoblju opšteg obrazovanja, Administrativnog Uputstva br.05/2015 normativi za nastavnike stručnog obrazovanja, Administrativnog Uputstva br.07/2017 o regulisanju procedura konkurisanja u Javnom sektoru, Odluke MONT-a br.232/01B, Odluke MONT-a br.231/01B od dana 04.08.2015, zahteva MONT-a ref.2-2955 od dana 01.07.2016, Direktorijati za Obrazovanje u Dragašu objavljuje:

KONKURS- re objavljivanje

Za popunjavanje slobodnih mesta za predškolsko, niže srednje osnovno obrazovanje Opštine Dragaš za školsku 2020/2021 godinu.

ONSŠ "Fetah Sylejmani" Dragaš
Nastava na Bosanskom jeziku

- Jedan nastavnik za razrednu nastavu u Dragašu (dok se uposlana ne vrati sa trudničkog bolovanja)
- Jedan nastavnik Historie (10 sati)

I. Sa aplikacijom se prilažu sledeća dokumenta:

- Formulari za konkurisanje dobijaju se pri Direktorijatu Obrazovanja, gde se i predaju sa ostalom popratnom dokumentacijom.
- Lični dokumenat (kopija lične karte ili pasoša)
- Diploma mora biti overena, u protivnom se neće smatrati validnom (ili sertifikati), sertifikati moraju da budu overeni kod notera i ne stariji od 6 meseca.
- Kandidati koji su diplomirali van Republike Kosova, trebaju dostaviti nostrifikovanu diplomu.
- Potvrda da kandidat nije pod istragom.
- Potvrda o radnom iskustvu u obrazovanju (ako poseduje).

Početak rada za gore pomenuta mesta, ne znači da će obavezno početi dana 01.09.2020, već u zavisnosti realnog oslobadanja radnog mesta u IEAA (datuma penzioniranja ili trudničkog bolovanja itd.)

Konkurs je otvoren **15 dana**, od dana objavljivanja u sredstvima informisanja.

Napomena: Dokumentacija za konkurisanje se ne vraća kandidatima.

Dana: 27.08.2020,
Dragaš

Direktor DO-a
MSc. Vloran Cenaj

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abrrapa Teatr-it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Gresa Studio” SH.P.K në Prishtinë ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër: NRB. Biznesit 810131962 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë Kooperativë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gresa Studio” L.L.C, Od Prishtine donelo odluku o prestani rada sa bisnisom : NRB. Biznesit: 810131962 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Gresa Studio” L.L.C, In Prishtina has come to the decision to quit its business: NRB. Biznesit: 810131962 The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

**Gjej PUNË**

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook 

www.facebook.com/gjejpuneshpejta

RESTAURANT**SWISS
TAVERNA**

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Stop Market”, SH.P.K. me adresë: Rr. Rexhep Bislimi, pn. Ferizaj, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811372440 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Stop Market” D.O.O. Rr. Rexhep Bislimi, pn. Ferizaj, donelo odluku o prestani rada sa NUI: 811372440, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Stop Market” L.L.C. Rr. Rexhep Bislimi, pn. Ferizaj, has come to the decision to quit its NUI: 811372440 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

► Ardi Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shf " Emin Duraku " Prizren.

► Luan Thaqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shf " Matilo Goreci " Prizren.

► Arjan Misini shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Hysni Kryeziu shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

► Mahzade Kera shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës se mesme " Sami Frashërti " në Prishtinë.

► Erion Selimi shpalle të pavlefshme dëftesat e Kl 6-8 , Sh.F.M.U. "Ilaz Thaqi" Hani Elezit.

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275